



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.161

6 dhjetor

2010

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Akt normativ nr.5, datë 10.11.2010	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.10142, datë 15.5.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të Punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë” 8407
Vendim i KM nr.870, datë 3.11.2010	Për miratimin e raportit fillestar kombëtar, në kuadër të protokollit opsional të Konventës së OKB-së “Për të drejtat e fëmijëve”, për përfshirjen e fëmijëve në konflikte të armatosura..... 8408
Vendim i KM nr.875, datë 3.11.2010	Për një ndryshim në vendimin nr.1720, datë 29.10.2008 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret e përcaktimit të nivelit të lartë sportiv, për mënyrën e shpërblimit të sportistëve, që i arrijnë këto nivele, si dhe për përfitimin e trajtimit për përgatitjen sportive”, të ndryshuar..... 8418
Vendim i KM nr.876, datë 3.11.2010	Për disa ndryshime në vendimin nr.78, datë 8.2.2006 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike”, të ndryshuar..... 8418
Vendim i KM nr.885, datë 3.11.2010	Për një ndryshim në vendimin nr.431, datë 11.12.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë Gramsh të qarkut të Elbasanit” dhe për një ndryshim në vendimin nr.818, datë 6.12.2006 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve” 8419

Vendim i KM nr.887, datë 3.11.2010	Për disa shtesa e ndryshime në vendimin nr.1146, datë 5.8.2008 të Këshillit të Ministrave “Për heqjen e disa ngastrave nga fondi pyjor dhe kullosor, që do të përdoren për vendosjen e anemometrave të nënstacioneve, për infrastrukturën lidhëse elektrike, për aerogjeneratorët, shtyllat e tensionit të lartë, si dhe për rrugët lidhëse me aerogjeneratorët”	8420
Vendim i KM nr.888, datë 3.11.2010	Për emërimin e anëtarëve të bordit drejtues të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, të përzgjedhur nga sektori ekonomik privat.....	8429
Vendim i KM nr.889, datë 11.11.2010	Për një shtesë në vendimin n.591, datë 23.7.2010 të Këshillit të Ministrave “Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore”, të ndryshuar.....	8429
Vendim i KM nr.890, datë 12.11.2010	Për rishpërndarje fondesh në buxhetin e vitit 2010, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.....	8430
Vendim i KM nr.891, datë 10.11.2010	Për përcaktimin e listës së Standardeve të Harmonizuara Shqiptare, që kanë karakter referues për prezumimin e sigurisë të produkteve për konsumatorin.....	8430
Vendim i KM nr.892, datë 10.11.2010	Për rishpërndarje fondi limit, brenda buxhetit të miratuar për vitin 2010, nga Ministria e Mbrojtjes, në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.....	8434
Vendim i KM nr.893, datë 10.11.2010	Për disa shtesa në vendimin nr.591, datë 23.7.2010 të Këshillit të Ministrave “Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore”, të ndryshuar.....	8434
Vendim i KM nr.894, datë 10.11.2010	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Lenie, të qarkut të Elbasanit.....	8436
Vendim i KM nr.895, datë 10.11.2010	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Bërdicë, të qarkut të Shkodrës.....	8437
Vendim i KM nr.914, datë 17.11.2010	Për pagesën e kontributeve të NATO-s, për vitin 2010.....	8438
Vendim i KM nr.963, datë 24.11.2010	Për shtyrjen e afatit të botimit të njoftimit të fituesit dhe të njoftimit të kontratës së lidhur për përfundimin e procedurave të prokurimit, me objekt “Shtypjen e “Fletore Zyrtare” për vitin 2010”, të kryera nga Qendra e Publikimeve Zyrtare, si autoritet kontraktor.....	8440
Vendim i KM nr.974, datë 3.12.2010	Për shpalljen e gjendjes së emergjencës civile (fatkeqësisë natyrore), në zonat e përmbytura, si pasojë e reshjeve në qarqet e Durrësit e të Lezhës.....	8440
Urdhër i MPPT nr.147, datë 20.10.2010	Për miratimin e rregullores “Për specifikimet në programet e kontrollit të cilësisë së sigurisë së aviacionit civil”	8441
Urdhër i MPPT nr.148, datë 20.10.2010	Për miratimin e rregullores “Për përcaktimin e procedurave për kryerjen e inspektimeve në fushën e sigurisë së aviacionit civil”	8442

AKT NORMATIV
Nr.5, datë 10.11.2010

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.10 142, DATË 15.5.2009 “PËR SIGURIMIN SHOQËROR SUPLEMENTAR TË USHTARAKËVE TË FORCAVE TË ARMATOSURA, TË PUNONJËSVE TË POLICISË SË SHTETIT, TË GARDËS SË REPUBLIKËS, TË SHËRBIMIT INFORMATIV TË SHTETIT, TË POLICISË SË BURGJEVE, TË POLICISË SË MBROJTJES NGA ZJARRI DHE TË SHPËTIMIT E TË PUNONJËSVE TË SHËRBIMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në ligjin nr.10 142, datë 15.5.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

1. Në pikën 2 të nenit 4, paragrafi i dytë dhe i tretë ndryshohen, si më poshtë vijon:

“Për efekt të llogaritjes së përfitimeve:

a) Paga referuese neto është paga që rezulton pas zbritjes, nga paga referuese, të kontributit të detyrueshëm të sigurimit shoqëror dhe shëndetësor plus tatimin mbi të ardhurat personale plus kontributin suplementar, sipas këtij ligji, të cilat mbahen nga paga.

b) Paga mesatare referuese llogaritet si mesatare e pagave referuese sipas periudhave të qëndrimit në atë gradë apo funksion.

c) Paga mesatare referuese neto është paga e barabartë me pagën referuese mesatare, pasi i zbritet shuma e kontributit të sigurimit shoqëror shëndetësor, tatimit mbi të ardhurat dhe kontributit suplementar, sipas këtij ligji, të cilat mbahen nga paga.

Pagat referuese të njësuara, rregullat e llogaritjes së pagës referuese neto dhe rregullat e llogaritjes së pagës mesatare referuese neto, për të gjithë karrierën, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

2. Pas pikës 4 të nenit 4 shtohet pika 5, me këtë përmbajtje:

“5. Kudo ku, në këtë ligj, për efekt të llogaritjes së përfitimeve, përdoret shprehja “pagë mesatare referuese”, do të zëvendësohet me shprehjen “pagë mesatare referuese neto”, ndërsa shprehja “pagë referuese” zëvendësohet me “pagë neto referuese.”.

Neni 2

Në nenin 5, pika 3, shifra “...2%...” bëhet “...5%...”

Neni 3

Pikat 1 dhe 2 të nenit 14, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“1. Pensioni i parakohshëm, për personat që plotësojnë kushtet e përfitimit, është 1.5 për qind e pagës mesatare referuese mujore neto, për çdo vit shërbimi.

2. Në çdo rast, masa e pensionit të parakohshëm nuk mund të jetë më e ulët se pensioni bazë, i përcaktuar nga Këshilli i Ministrave, në përputhje me ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.”.

Dispozita kalimtare dhe të fundit

Neni 4

Kërkesa për përfitim, sipas përcaktimeve të pikës 1 të nenit 28 të ligjit nr.10 142, datë 15.5.2009, nga personat që e drejta u ka lindur por nuk është ushtruar, mund të ushtrohet deri më 31.12.2010 dhe përfitimi do të jepet nga data e hyrjes në fuqi të ligjit të sipërpërmendur.

Shumat e pensioneve të parakohshme, të rillogaritura, kur rezulton shtesë mbi shumat e përfituara më parë, i paguhen përfituesit me këste, sipas përcaktimeve, me vendim të Këshillit të Ministrave, në përputhje me parashikimet në buxhetin e vitit përkatës.

Neni 5

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë, botohet në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare, si më poshtë:

- a) Për përfitimet, nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr.10 142, datë 15.5.2009;
- b) Për ndryshimin e normës së kontributit, nga data 1.1.2011.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM

Nr.870, datë 3.11.2010

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT FILLESTAR KOMBËTAR, NË KUADËR TË PROTOKOLLIT OPSIONAL TË KONVENTËS SË OKB-SË “PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE”, PËR PËRFSHIRJEN E FËMIJËVE NË KONFLIKTE TË ARMATOSURA

Në mbështetje të neneve 100 e 122 të Kushtetutës dhe të nenit 1 të ligjit nr.9833, datë 22.11.2007 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin opsional të konventës së OKB-së “Për të drejtat e fëmijëve”, për përfshirjen e fëmijëve në konflikte të armatosura”, me propozimin e Ministrisë të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e raportit fillestar kombëtar, në kuadër të protokollit opsional të konventës së OKB-së “Për të drejtat e fëmijëve”, për përfshirjen e fëmijëve në konflikte të armatosura.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

RAPORTI FILLESTAR
KOMBËTAR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË MBI PROTOKOLLIN OPSIONAL TË KONVENTËS
NDËRKOMBËTARE “PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE”, PËR PËRFSHIRJEN E FËMIJËVE NË
KONFLIKTE TË ARMATOSURA

CRS/OP/AC/1
(2007-2009)

SHKURTIME

Kushtetuta	Kushtetuta e Shqipërisë
Kuvendi	Kuvendi i Shqipërisë
RSH	Republika e Shqipërisë
Protokoll i kuadër	Protokoll i opsional i konventës ndërkombëtare “Për të drejtat e fëmijëve”, për përfshirjen e fëmijëve në konflikte të armatosura”
FA(RSH)	Forcat e Armatosura (të Republikës së Shqipërisë)
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
KDS	Komanda e Doktrinës Stërvitëse
KF	Kodi i Familjes në Republikën e Shqipërisë
KC	Kodi Civil në Republikën e Shqipërisë
KPU	Kodi Penal Ushtarak në Republikën e Shqipërisë

HYRJE

Protokoll i opsional i konventës ndërkombëtare “Për të drejtat e fëmijëve”, për përfshirjen e fëmijëve në konflikte të armatosura” (në vijim protokoll i kuadër) është ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë (në vijim Kuvendi) me ligjin nr.9233, datë 22.11.2007 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin opsional të konventës së OKB-së “Për të drejtat e fëmijëve”, për përfshirjen e fëmijëve në konfliktet e armatosura”.

Në përputhje me nenin 122, paragrafi I, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (në vijim Kushtetuta), ky protokoll është bërë “pjesë e sistemit të brendshëm juridik” prej botimit të tij në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë me nr.165, datë 10 dhjetor 2007, shpallur me dekretin e Presidentit të Republikës së Shqipërisë (nr.5529, datë 4.12.2007), ligji për aderimin e Republikës së Shqipërisë (në vijim RSH) në protokollin kuadër ka hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Paraqitja e Raportit Kombëtar Fillestar, përveçse një detyrim (referuar paragrafit 2 të nenit 8 në protokollin kuadër), përbën angazhimin e Shqipërisë në lidhje me masat e marra që sigurojnë zbatimin efektiv të protokollit kuadër në planin e brendshëm. Ai paraqet një përmbledhje të kuadrit kushtetues, ligjor, administrativ dhe institucional në RSH, si edhe ndryshimet që ato kanë pësuar prej ratifikimit të tij nga Shqipëria në vitin 2007.

Materiali që po paraqitet është hartuar nga Ministria e Punëve të Jashtme në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Mbrojtjes. Struktura e tij i përmbahet udhëzimeve paraprake të dokumentit (CRC/OP/AC/I), të miratuara në sesionin e 28-të të Komitetit për të Drejtat e Fëmijëve dhe publikuar nga ky i fundit në datën 12 tetor 2001.

PJESA E PARË

Informacion i përgjithshëm - kuadri legjislativ në Republikën e Shqipërisë, në zbatim të protokollit opsional të konventës ndërkombëtare “Për të drejtat e fëmijëve”, për përfshirjen e fëmijëve në konflikte të armatosura”

I/a- Përcaktimi i termit “fëmijë” në legjislacionin shqiptar

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë mbron “të drejtat dhe liritë themelore të njeriut” dhe i konsideron ato si “të pandashme, të patjetërsueshme, të padhunueshme”, të cilat qëndrojnë në “themel të

të gjithë rendit juridik”. Si të tilla, ato iu garantohen dhe vlejnë njëllor si për shtetasit shqiptarë, shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi, pa asnjë lloj dhe forme diskriminimi.¹

2. Detyrimi i shtetasit shqiptar për të kontribuar në mbrojtjen e Republikës së Shqipërisë është sanksionuar në nenin 166 të Kushtetutës, i cili përcakton se “Shtetasit shqiptarë kanë për detyrë të marrin pjesë në mbrojtjen e Republikës së Shqipërisë, siç parashikohet në ligj”.

3. Lidhur me subjektin e protokollit kuadër, neni 54 i Kushtetutës së RSH u garanton “fëmijëve dhe të rinjve” (krahas grave shtazëna dhe nënave të reja) “të drejtën e një mbrojtjeje të veçantë nga shteti”. Nëpërmjet së njëjtës dispozitë, legjislatori shqiptar i garanton çdo fëmijë (të lindur nga martesë apo jashtë saj) të drejtën për t’u mbrojtur nga “dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe përdorimi për punë, e veçanërisht nën moshën minimale për punën e fëmijëve, që mund të dëmtojë shëndetin, moralin ose të rrezikojë jetën a zhvillimin e tyre normal”.

4. Pavarësisht kuptimit të termit “fëmijë” në jetën e përditshme, në legjislacionin shqiptar nuk mund të gjejmë asnjë përkufizim juridik të tij. Kështu, në nenin 2 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, ky subjekt konsiderohet si “person” dhe lidhet në mënyrë të pazgjydhshme me institutin e “zotësisë juridike”. Shprehimisht, në këtë nen parashikohet se “Zotësia juridike fillon me lindjen e personit gjallë dhe mbaron me vdekjen e tij. Fëmija kur lind i gjallë gëzon zotësi juridike që nga koha e zënies”.

5. Ndonëse njëra nga tri pjesët e Kodit të Familjes së Republikës së Shqipërisë² (në vijim KF) titullohet “Fëmijët”, në të nuk jepet përkufizimi ligjor i këtij subjekti. Nëpërmjet dispozitave që përcaktojnë tagrin e atësisë, amësisë, përgjegjësinë prindërore, birësimin, kujdestarinë etj., “fëmijët” prezantohen si persona të një moshë të vogël (jo madhore), për shkak të së cilës krijojnë natyralisht dhe ligjërisht marrëdhënie varësie me prindërit/autoritetin prindëror, në lidhje me ushtrimin e të drejtave.

6. Në Kodin Civil të RSH-së (në vijim KC), e drejta kushtetuese për “Ushtrimin e të drejtave” lidhet ngushtë me zotësinë për të vepruar të personit, dhe kjo në mënyrë direkte me moshën e tij. Në paragrafin e parë të nenit 6 të KC-së, parashikohet se personi që ka mbushur moshën 18 vjeç i lind zotësia e plotë juridike, që me veprimet e tij të fitojë të drejta dhe të marrë përsipër detyrime civile.

7. Personat, të miturit, që nuk kanë mbushur ende moshën 14 vjeç, janë të pazotë për të vepruar, por mund të kryejnë veprime juridike që i përshtaten moshës së tyre apo që i sjellin atyre dobi pa asnjë kundërshtim. Për të gjitha veprimet e tjera juridike, ata duhet të asistohen nga një përfaqësues ligjor.³

8. I mituri që ka mbushur moshën 14 vjeç mund të kryejë veprime juridike, vetëm duke marrë më parë pëlqimin e përfaqësuesit të tij ligjor.

Në interpretim të neneve 6 dhe 8 të KF-së, të gjithë të miturit midis moshës 14 deri në 18 vjeç, kanë të drejtë të kryejnë veprime juridike pasi kanë marrë më parë pëlqimin e përfaqësuesve të tyre ligjorë.

9. Zotësia për të vepruar hiqet me vendim gjykatë, në rastet kur: a) i mituri me moshë 14 deri në 18 vjeç është i pazoti të kujdeset për punën e tij, si shkak i një sëmundjeje psikike ose një zhvillimi të metë mendor; b) personi madhor, si shkak i një sëmundjeje psikike ose zhvillimi të metë mendor, është pjesërisht ose tërësisht i pazoti të kujdeset për punët e tij.⁴

I/b — Instrumentet ligjore për zbatimin e protokollit kuadër në Republikën e Shqipërisë

10. Anëtarësimi i Republikës së Shqipërisë në një numër tashmë të konsiderueshëm konventash ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, nënkupton njëkohësisht angazhimin dhe detyrimin e saj për pasqyrimin e tyre në legjislacionin vendas.

11. Pavarësisht faktit se praktikat ligjore në këtë drejtim kanë qenë të pakta, legjislacioni shqiptar garanton zbatimin korrekt të protokollit kuadër. Në kuadrin ligjor shqiptar nuk vërejmë asnjë ligj specifik, i cili të jetë hartuar me qëllimin e veçantë në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve të përfshirë në konflikte të armatosura. Masat e marra në këtë drejtim pasqyrohen në ligje të veçanta, sipas rasteve konkrete.

¹ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë - nenet 15, 16, 17 dhe 18

² Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë - miratuar me ligjin nr.9062, datë 5.8.2003, i ndryshuar

³ Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë — neni 7

⁴ Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë — nenet 9 dhe 10

PJESA E DYTË
ZBATIMI I DISPOZITAVE TË NENEVE TË VEÇANTA TË PROTOKOLLIT KUADËR NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Neni 1

12. Procesi i rekrutimit të shtetasve shqiptarë në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë (në vijim FARSH), realizohet në përputhje me aktet ligjore të mëposhtme.

13. Ligji nr.9047, datë 10.7.2003 “Për shërbimin ushtarak në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar⁵ ka si objekt të tij përcaktimin: a) e rregullave për kryerjen e shërbimit ushtarak në Republikën e Shqipërisë; b) të drejtave, detyrimeve dhe përgjegjësive të shtetasve, organeve shtetërore e subjekteve private për mobilizimin dhe shërbimin ushtarak.

14. Ligji nr.9210, datë 23.3.2004 “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura në Republikën e Shqipërisë” ka për qëllim përcaktimin e pozitës juridike, ekonomike-financiare dhe shoqërore, kërkesat e përgjithshme të pranimit, të drejtat, detyrimet dhe kufizimet e ushtarakëve të FARSH, për arsye të karakterit të veçantë të detyrës dhe të shërbimit ushtarak, si dhe garancitë ligjore për zbatimin e tyre.

15. Ligji nr.9171, datë 22.1.2004 “Për gradat dhe karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë” përcakton: a) kriteret dhe autoritetin për pranimin në FA; b) rendin e gradave, përparimin në gradë dhe në karrierë; c) përgjegjësitë që rrjedhin nga karakteri i veçantë i detyrës dhe shërbimit ushtarak; d) ndërprerjen e karrierës për ushtarakët e FA-së.

16. Në nenin 2, paragrafi 2, të ligjit nr.9047, datë 10.7.2003 “Për shërbimin ushtarak në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, “Mobilizimi ushtarak” përkufizohet si “detyrim ligjor i shtetasit, person fizik e juridik, për të marrë pjesë ose për të siguruar plotësimin e njësisë e reparteve të strukturave ushtarake me personel, materiale, teknike, kafshë, automjete e mjete të tjera të nevojshme”.

Pjesëmarrja e shtetasve shqiptarë në “shërbimin ushtarak” është një detyrim kushtetues, në kuadrin e mbrojtjes në RSH, si dhe përmbushjen e detyrimeve të shtetit ndaj organizmave ndërkombëtarë, ku ai bën pjesë (neni 2, paragrafi 5, po aty).

17. Për shtetasit shqiptarë, mbajtës të një shtetësie të dytë, ky ligj parashikon se kryerja e shërbimit ushtarak aktiv ose alternativ në shtetin e dytë, sipas ligjeve të këtij të fundit, konsiderohet si një detyrim i përmbushur për shtetin shqiptar. Shtetasi shqiptar, mbajtës i një shtetësie të dytë dhe me banim të përhershëm në territorin shqiptar, është i lirë që deri në moshën 19 vjeç, të zgjedhë se cilin prej shërbimeve ushtarake do të kryejë (neni 5, po aty).

18. Shërbimi ushtarak në Republikën e Shqipërisë ndahet në dy kategori: shërbim i detyrueshëm ushtarak aktiv dhe shërbimi alternativ i detyrueshëm.

Në nenin 9, pika 1, të ligjit të mësipërm përcaktohet se “shërbimi i detyrueshëm ushtarak aktiv dhe alternativ kryhet nga shtetasi shqiptar, mashkulli i moshës 19 deri në 27 vjeç, i cili plotëson kriteret e përcaktuara në këtë ligj. Thirrja e shtetasit për kryerjen e shërbimit të detyrueshëm ushtarak aktiv dhe alternativ fillon sapo mbush moshën 19 vjeç e deri në moshën 26 vjeç”.

Në rast mobilizimi të përgjithshëm ose të pjesshëm, me ligj ose me dekret të Presidentit të Republikës, thirret për shërbim ushtarak edhe shtetasi i moshës 18 vjeç.

19. Shërbimi alternativ i detyrueshëm zbatohet për të gjithë ata shtetas që, për arsye ndërgjegjeje, nuk pranojnë të kryejnë shërbimin me armë në FA (neni 20, pika 1, po aty). Kërkesa për kryerjen e një shërbimi të tillë, së bashku me dokumentacionin shoqërues, paraqiten në qendrën e rekrutim-mobilizimit ose në komandën e njësisë (repartit ushtarak), përpara se shtetasi të plotësojë moshën ligjore të thirrjes për kryerjen e shërbimit të detyrueshëm ushtarak.

20. Shërbimi ushtarak aktiv dhe në rezervë kryhet në FA, ndërsa ai alternativ kryhet në institucionet publike ose në FA (neni 7, po aty).

⁵ Ndryshuar me ligjet nr.9487, datë 6.3.2006 dhe nr.9999, datë 25.9.2008

Kohëzgjatja e shërbimit ushtarak aktiv ose alternativ është 12 muaj (neni 10, paragrafi 1, po aty).

21. Kuadri ligjor për Forcat e Armatosura rregullon jo vetëm shërbimin e detyrueshëm ushtarak aktiv, por edhe shërbimin ushtarak vullnetar. Ky rregullim është parashikuar jo vetëm në dispozitat e ligjit nr.9047, datë 7.4.2003 “Për shërbimin ushtarak në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, por edhe në ligjin nr.9171, datë 22.1.2004 “Për gradat dhe karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë” dhe ligjin nr.8671, datë 26.10.2000 “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

22. Në vijim ju sqarojmë se pika 2 e nenit 5 të ligjit nr.9171, datë 22.1.2004 “Për gradat dhe karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, përcakton se oficer, nënoficer dhe ushtar aktiv me pagesë në FA, pranohet shtetasi shqiptar që, përveç kritereve të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, është në moshën 19-30 vjeç.

Kjo dispozitë ndalon rekrutimin e shtetasve nën 19 vjeç edhe në shërbimin vullnetar.

23. I njëjti kriter moshe zbatohet edhe për shtetasit që dëshirojnë të pranohen në FARSH (neni 4 i ligjit nr.9210 “Për statusin e ushtarakut në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”). Kritere të tjera të aplikuara në këtë rast lidhen me domosdoshmërinë: a) e pasjes së shtetësisë shqiptare; b) e pasjes së zotësisë së plotë për të vepruar c) e përmbushjes së kërkesave ligjore për nivelin arsimor dhe zotërimin e aftësive shëndetësore dhe fizike për vendin e punës; d) e të qenit i padënuar me burgim nga gjykata; e) e moslargimit nga puna për shkelje të disiplinës.

24. Në hierarkinë ushtarake, ushtarakët janë oficerë, nënoficerë dhe ushtarë. Rekrutët e rinj dhe ushtarët profesionistë, kur hyjnë në shërbimin aktiv, nuk mbajnë gradë por quhen “rekrutë” deri në përfundimin me sukses të stërvitjes bazë, kohë që zgjat deri në 3 muaj. Pas përfundimit të kësaj periudhe rekrutët gradohen “Rekrut i I-rë” ose “Detar i I-rë”, ndërsa rekrutët ushtarë profesionistë gradohen “Ushtar profesionist I”.⁶

25. Nga raportet statistikore të organeve përgjegjëse, rekrutimet e bëra për periudhën 2007-2009 rezultojnë në shifrat si vijon:

Nr.	Viti	Shtetas të rekrutuar
1.	2007	2446
2.	2008	2349
3.	2009	1894

26. Lidhur me sa më sipër, strukturat përgjegjëse pranë Ministrisë së Mbrojtjes deklarojnë se në FA e Republikës së Shqipërisë në asnjë rast nuk ka pasur raste të rekrutimit të personave të mitur, të moshës nën 18 vjeç.

27. Në mbështetje të Strategjisë Ushtarake të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, Qeveria Shqiptare ka ndërmarrë hapa seriozë në kuadër të krijimit të një ushtrie profesioniste sipas standardeve të NATO-s. Është tashmë një fakt i njohur që, prej muajit shtator të vitit 2009 dhe në vazhdim, nuk kryhet më rekrutimi i shtetasve për shërbimin e detyrueshëm ushtarak aktiv.

Neni 2

28. Kuadri ligjor i sipërpërmendur përbën një garanci për mosrekrutimin me detyrim të fëmijëve nën 18 vjeç në FARSH, pasi në asnjë rast, qoftë dhe vullnetarisht, nuk parashikohet rekrutim i shtetasve nën atë moshë.

29. Të gjitha aktet nënligjore të nxjerra nga Ministria e Mbrojtjes dhe strukturat e saj vartëse, të cilat lidhen me rekrutimin në FA janë nxjerrë në përputhje e bazën ligjore të lartpërmendur dhe janë në

⁶ Nenet 4, 9 dhe 10 të ligjit nr. 9171, datë 22.1.2004 “Për gradat dhe karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”

përputhje edhe me protokollin fakultativ të konventës “Për të drejtat e fëmijëve”, për përfshirjen e fëmijëve në konflikte të armatosura”.

30. Moszbatimi i akteve ligjore dhe i atyre nënligjore në fushën e mbrojtjes sanksionohet nga Kodi Penal Ushtarak i Republikës së Shqipërisë (në vijim KPU)⁷. Në të përcaktohen veprat penale ushtarake, si dhe dënimet dhe masat e tjera që merren ndaj subjekteve që i kryejnë ato. Veprat penale ushtarake ndahen në krime ushtarake dhe në kundërvajtje penale ushtarake. Dallimi i tyre bëhet në çdo rast në dispozitat e pjesës së posaçme të atij kodi (neni 1, po aty).

31. Referuar nenit 6 të KPU-së, ligji penal ushtarak zbatohet mbi të gjithë ata persona që bëjnë pjesë në Forcat e Armatosura, gjithashtu edhe ata persona që ligji i barazon me ushtarakët. Në lidhje me protokollin kuadër që raportohet, subjekte të këtij ligji janë edhe “të thirrurit në stërvitje, prova gatishmërie dhe mobilizimi” (neni 3, pika 4, po aty).

Detyrimi për respektimin e dispozitave të këtij ligji, në rastet e rekrutimit dhe mobilizimit të personave në FA të RSH-së, parashikohet në nenet 15, 16, 18 dhe 19 të KPU-së.

32. Neni 15 - “Shmangia nga evidenca ushtarake” ose mosbërja e ndryshimeve në evidencën ushtarake, të kryera me shumë se një herë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë muaj.

33. Neni 16 - “Shmangia nga thirrja për shërbim ushtarak” e shtetasit shqiptar, për të kryer shërbimin e detyrueshëm ushtarak, kur nuk përbën kundërvajtje administrative, dënohet si kundërvajtje penale me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.

34. Neni 18 - “Mashtrimi për rekrutim”, parashikon shprehimisht se “çdo person që, për të rregulluar rekrutimin ose largimin e tij nga Forcat e Armatosura, paraqet të dhëna të pasakta ose i fsheh ato, kryen kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në vjet”.

35. Neni 19 - “Rekrutimi i paligjshëm”, konsiderohet si kundërvajtje penale dhe dënon me gjobë ose me burgim deri në dy vjet, çdo person që ndihmon personat e tjerë për të përfituar rekrutimin/emërimin/largimin nga forcat e armatosura, pa plotësuar kushtet e parashikuara me ligj.

36. Përtej dispozitave të këtij kodi, masa të tjera që garantojnë zbatimin korrekt të nenit 2 të protokollit kuadër konsiderohen dhe vendimet e Këshillit të Ministrave (në vijim VKM), në të cilat përcaktohet forma dhe mënyra e funksionimit të organeve të veçanta që veprojnë në procesin e rekrutimit. Përmendim këtu VKM nr.39, datë 22.1.2004 “Për përbërjen, funksionimin, detyrat dhe të drejtat e komisionit alternativ” dhe VKM nr.69, datë 29.1.2004 “Për kriteret dhe masën e pagesës për t’u përjashtuar nga shërbimi i detyrueshëm ushtarak dhe për disa ndryshime në vendimin nr.244, datë 20.4.2001 të Këshillit të Ministrave “Për masën e pagesës për përjashtimin nga shërbimi i detyrueshëm ushtarak aktiv, si dhe për trajtimin e ushtarëve me pagesë”.

37. Ulja e moshës së rekrutimit në FARSH mund të bëhet me ligj ose me dekret të Presidentit të Republikës, në rastet e mobilizimit të përgjithshëm ose të pjesshëm. Kjo parashikohet në nenin 9, pika 1, të ligjit nr.9047, datë 10.7.2003 “Për shërbimin ushtarak në RSH”, të ndryshuar. Mosha e rekrutimit për këtë rast mund të ulët deri në 18 vjeç. Në asnjë rrethanë tjetër nuk parashikohet dhe nuk lejohet rekrutimi i fëmijëve nën atë moshë.

Neni 3

38. Mosha minimale për rekrutim vullnetar në FARSH, përcaktuar edhe në nenin 4 të ligjit nr.9210, datë 23.3.2004 “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura në Republikën e Shqipërisë”, është 19 vjeç. Sikurse është raportuar dhe për nenin 2 në këtë dokument, të njëjtit kufi minimal të moshës i referohet edhe pika 2 e nenit 5, në ligjin nr.9171, datë 22.1.2004 “Për gradat dhe karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”. Kjo bazë ligjore vjen në përputhje me protokollin që raportohet.

39. Në kuadrin ligjor të sipërpërmendur përcaktohen procedurat dhe dokumentacioni përkatës, mbi bazën e të cilit bëhet rekrutimi vullnetar. Dokumentacioni përkatës që duhet që të konstatohet dhe të vërtetohet, mes fakteve të tjera, edhe moshën e personit kandidat për rekrutim vullnetar.

⁷Miratur me ligjin nr.8003, datë 2809,1995 dhe ndryshuar me ligjin nr.8919, datë 4.7.2002

40. Po ashtu në udhëzimin e Ministrit të Mbrojtjes nr.2, datë 12.2.2008, përcaktohen kriteret, dokumentet dhe procedurat e rekrutimit të ushtarëve profesionistë në FA. Shtetasit, të cilët dëshirojnë të rekrutohen në shërbimin profesionist, paraqesin pranë qendrave të rekrutimit kërkesën personale dhe dokumentacionin e kërkuar. Për të verifikuar moshën e vullnetarëve për shërbimin profesionist, dokumenti i besueshëm është certifikata personale ose karta e identitetit. Kandidatët i nënshtrohen testit fizik, intelektual pranë qendrës së personel-rekrutimit dhe më pas edhe ekzaminimit mjekësor në Spitalin Qendror Ushtarak të FA-së.

41. Kandidatët i nënshtrohen testimit fizik dhe intelektual pranë qendrës së personel-rekrutimit dhe më pas edhe ekzaminimit mjekësor në Spitalin Qendror Ushtarak të FA. Referuar nenit 27 të ligjit nr.9047, datë 10.7.2003 “Për shërbimin ushtarak në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, kjo qendër përgjigjet për zbatimin e programit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, për përcaktimin, sigurimin e personelit të nevojshëm për shërbimin e detyrueshëm aktiv, rezervist dhe atë profesionist me pagesë.

42. Në vijim, në nenin 28 të të njëjtit ligj, përcaktohet mënyra e ngritjes, në qendrën e rekrutim-mobilizimit, të komisionit mjekësor të kontrollit të aftësive fizike dhe shëndetësore të shtetasit, që thirret në shërbimin ushtarak.

43. Pranë Spitalit Ushtarak Qendror Universitar krijohet dhe funksionon komisioni mjekësor i kontrollit të aftësive fizike e shëndetësore, ku përveç ushtarakëve, testohen dhe të shtetasit që dërgohen nga qendra e rekrutim-mobilizimit të qarkut.

Përbërja e komisioneve, detyrat dhe përgjegjësitë përcaktohen në rregulloren e aftësive fizike e shëndetësore të shtetasit dhe ushtarakut, e cila miratohet bashkërisht nga Ministri i Mbrojtjes dhe Ministri i Shëndetësisë.

44. Shtetasi shqiptar, me fillimin e shërbimit ushtarak, bën betimin sipas formulës së mëposhtme:

- “Betohe se do t’i shërbej me besnikëri Republikës së Shqipërisë; do të jem ushtar besnik i popullit tim, luftëtar i denjë, trim e i disiplinuar, do të jem i gatshëm në çdo kohë e vend dhe nuk do të kursej as jetën time për mbrojtjen e interesave të Atdheut. Betohe!”

45. Koha e shërbimit të detyrueshëm kushtëzohet nga disa faktorë që kanë të bëjnë me lirim para kohe nga ky shërbim. Rastet e lirit para kohe, të parashikuara në nenin 14 të ligjit nr. 9047 datë 10.7.2003 “Për shërbimin ushtarak në RSH”, të ndryshuar, janë si vijon:

a) Kur cilësohet i paaftë për vazhdimin e shërbimit me vendim të Komisionit Mjekësor të Spitalit Qendror Universitar të FA;

b) Për fatkeqësi të rënda familjare, kur prindërit ose bashkëshorti bëhet invalid ose vdes dhe fëmijët mbeten pa përkujdesje;

c) Kur pranohen studentë në shkollat e larta ushtarake ose në Akademinë e Policisë;

ç) Shtetasi kryefamiljar, i martuar dhe me një apo me shumë fëmijë të mitur;

d) Kur titullohet ushtar profesionist.

46. Ministria e Mbrojtjes në mënyrë vazhdueshme ka bërë përpjekje për të sensibilizuar të rinjtë, me qëllim përfshirjen e tyre në radhët e FA-së. Në kuadër të marrëveshjeve me vende të tjera në fushën e mbrojtjes, ajo ofron çdo vit bursa studimi jashtë vendit. Përhapja e informacionit kryesisht bëhet nëpërmjet medias vizive dhe asaj të shkruar. Përpos kësaj, vlen për t’u përmendur aktiviteti i përvitshëm (ditë të hapura për publikun), ku përfaqësues të njëjësive dhe reparteve të FA-së zhvillojnë takime me nxënës të shkollave të mesme dhe të larta, apo marrin pjesë në emisionet informuese të televizioneve kombëtare e lokale. Gjatë këtyre aktiviteteve, pjesëmarrësve iu vihen në dispozicion fletëpalosje dhe broshura, nëpërmjet të cilave prezantohet një informacion mjaftueshëm mbi arsimin ushtarak, përgatitjen fizike, misionet e ushtarëve tanë jashtë vendit etj.

47. Arsimimi dhe kualifikimi ushtarak bazohet në ligjin e gradave dhe karrierës ushtarake, ku janë të përcaktuara nivelet dhe kurset përkatëse që duhet të ndjekë personeli i FA-së. Moshë minimale e hyrjes në shkollat ushtarake është 19 vjeç.

48. Në Republikën e Shqipërisë, institucionet e sistemit arsimor ushtarak janë në varësi të Komandës së Doktrinës e Stërvitjes (në vijim KDS), e cila varet nga Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura të RSH. Aktualisht për të gjitha kurset institucionale dhe ato funksionale hartohet një plan arsimimi, i cili miratohet nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së. Plani përpilohet mbi bazën e

nevojave të reparteve dhe kapaciteteve të institucioneve tona arsimore, pas konsultimeve me të gjitha strukturat e interesuara. Në këto plane përshihen të gjitha institucionet arsimore të Forcave të Armatosura që funksionojnë aktualisht (si vijon).

- Universiteti Ushtarak “Skënderbej”;
- Qendra e Gjuhëve të Huaja në UUS;
- Akademia e Mbrojtjes “Spiro Moisiu”;
- Akademinë e Nënoficerëve “Thomson”;
- Shkolla e Trupës në KDS (për oficerët);
- Qendra e Stërvitjes Bazë, BUNAVI, KDS.

49. Në programet e arsimit ushtarak përfshihen ndër të tjera lëndët e të drejtës ushtarake, ndërkombëtare, humanitare, kushtetuese etj. Vëmendje të veçantë në këto programe iu kushtohet temave mbi liritë e të drejtat themelore të njeriut, si edhe mbrojtjes së popullsisë civile në zonën e një konflikti të armatosur.

50. Çdo institucion arsimor ushtarak disponon një rregullore të brendshme, në përputhje me aktivitetin e tij. Në këto rregullore përcaktohen rregulla të qarta dhe të aplikueshme për të siguruar një disiplinë të lartë shkollore.

Neni 4

51. Aktualisht, misionet paqeruajtëse ku marrin pjesë FARSH janë të vendosura në Çad dhe Afganistan. Në përputhje me kërkesat e NATO-s, personeli i ushtarakëve pjesëmarrës në to përzgjidhet nga kontingjenti i ushtarakëve profesionistë aktivë në FA. Kjo nënkupton se të gjithë personat pjesëmarrës në program janë të moshës mbi 18 vjeç.

52. Përkufizimi që përdoret në nenin 4 të protokollit kuadër, “Grupet e armatosura” (të ndara nga Forcat e Armatosura të një shteti”), nuk trajtohet nga asnjë dispozitë e legjislacionit penal në RSH. Të vetmen dispozitë që mund të përafrohet me subjektin e këtij neni e gjejmë në Kodin Penal të RSH-së. Në nenin 133 të tij, legjislatori shqiptar parashikon shprehimisht se: “Krijimi i bandës së armatosur dhe organizatës kriminale ose pjesëmarrja në to, me qëllim për kryerjen e krimeve, dënohet nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.”

53. Paragrafi I i nenit 134, po aty, parashikon se veprimet e kryera nga banda e armatosur apo organizata kriminale dënohen sipas dispozitave penale përkatëse duke shtuar në dënimin për krimin e kryer dhe pesë vjet burgim të tjera (kur dispozita përmban dënim me burgim apo dënim të llojit me të lehtë), pa kaluar gjithmonë kufirin maksimal të dënimit me burgim.

54. Personat e rekrutuar në “grupet e armatosura”, mbajnë përgjegjësi penale për veprimet e tyre, nëse në kohën e kryerjes së krimit kanë mbushur moshën katërmëdhjetë vjeç (neni 12, paragrafi 1, po aty).

55. Lidhur më sa më sipër, konstatohet se kuadri ligjor në Republikën e Shqipërisë garanton zbatimin e drejtë dhe korrekt të nenit 4 të protokollit kuadër.

Neni 5

56. Për periudhën që raportohet (2007-2009) nga ana e Shtetit Shqiptar nuk është marrë ndonjë masë ligjore, si pjesë e kuadrit ligjor, që garanton të drejtat e fëmijëve të përfshirë në konfliktet e armatosura. Kjo për faktin e thjeshtë se Republika e Shqipërisë nuk ka pasur apo marrë pjesë në konflikte të armatosura. Pavarësisht kësaj, kuadri ligjor i zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë garanton zbatimin efektiv të protokollit fakultativ.

Ai përfshin këto dokumente:

- Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (aderuar në vitin 1955);
- Konventa mbi të Drejtat e Fëmijëve - CRC (ratifikuar në 27 shkurt 1992 dhe ka hyrë në fuqi në mars 1992);
- Protokollin opsional i konventës mbi të drejtat e fëmijëve mbi shitjen e fëmijëve, prostitucionit të fëmijës dhe pornografisë së fëmijës (aderuar 5 shkurt 2008);

- Protokoll i opsional i konventës mbi të drejtat e fëmijëve, për përfshirjen e fëmijëve në konflikte të armatosura (aderuar më 9 tetor 2008);
- Konventa ndërkombëtare për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racial-CERD, (aderuar me 11 maj 1994);
- Aktin Final të Konferencës së Helsinkit, 1975;
- Konventa europiane “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore” (nënshkruar nga Republika e Shqipërisë me 13.7.1995, ratifikuar me 31.7.1996 dhe hyrë në fuqi më 2.10.1996);
- Protokollat 1, 2, 3,4, 5, 7, 8 të konventës europiane “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore” (hyrë në fuqi 2.10.1996);
- Protokoll nr.11 i konventës (hyrë në fuqi më 1.11.1998);
- Protokoll nr.12 i konventës (hyrë në fuqi në vitin 2005);
- Protokoll nr.13 i konventës “Për heqjen e dënimit me vdekje në të gjitha rrethanat” (hyrë në fuqi me 1.6.2007);
- Protokoll nr.14 i konventës (ratifikuar 30-2.2006);
- Konventa mbi shtetësinë (nënshkruar 7.5.1999, ratifikuar me 11.2.2004 dhe hyrë në fuqi 1.6.2004);
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (miratuar me ligjin nr.8417, datë 21.10.1998, i ndryshuar);
- Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë (miratuar me ligjin nr.7850, datë 29.7.1994), i ndryshuar;
- Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë (miratuar me ligjin nr.9062, datë 8.5.2003);
- Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë (miratuar me ligjin nr.7895, datë 27.1.1995), i ndryshuar;
- Kodi Penal Ushtarak i Republikës së Shqipërisë (miratuar me ligjin nr.8003, datë 28.0.1995), i ndryshuar;
- Ligji nr.9047, datë 10.7.2003 “Për shërbimin ushtarak në RSH”, i ndryshuar;
- Ligji nr.9210, datë 23.3.2004 “Për statusin e ushtarakut të FA-së në RSH”;
- Ligji nr.9171 datë 22.1.2004 “Për gradat dhe karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”;
- VKM nr.39, datë 22.1.2004 “Për përbërjen, funksionimin, detyrat dhe të drejtat e komisionit alternativ”;
- VKM nr.69, datë 29.1.2004 “Për kriteret dhe masën e pagesës për t’u përjashtuar nga shërbimi i detyrueshëm ushtarak dhe për disa ndryshime në vendimin nr.244, datë 20.4.2001 të Këshillit të Ministrave “Për masën e pagesës për përjashtimin nga shërbimi i detyrueshëm ushtarak aktiv, si dhe për trajtimin e ushtarëve me pagesë”.

Neni 6

57. Sikurse u raportohet edhe me sipër në nenin 5, në legjislacionit shqiptar nuk ka pasur asnjë nismë ligjore në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, të përfshirë në konflikte të armatosura. Të vetmet ndryshime të ndodhura kanë qenë ato në ligjin nr.9047, datë 10.7.2003 “Për shërbimin ushtarak në Republikën e Shqipërisë”.

58. Ligji nr.9487, datë 6.3.2006 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9047, datë 10.7.2003 “Për shërbimin ushtarak në Republikën e Shqipërisë””, përveçse disa ndryshimeve të lidhura me teknikën ligjore të aktit, parashikonte ndër të tjera përjashtimin nga shërbimi i detyrueshëm ushtarak të shtetasit shqiptar që kishte përfunduar studimet universitare me shkëputje nga puna, brenda ose jashtë vendit. Gjithashtu, ky ligj i jepte “titull ekzekutiv” vendimit të komisionit të shqyrtimit të kundërvajtjeve, të kryera pranë qendrave të rekrutim-mobilizimit.

59. Ndryshimet e bëra me ligjin nr.9999, datë 25.9.2008 “Për disa ndryshime në ligjin nr.9047, datë 10.7.2003 “Për shërbimin ushtarak në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, kanë të bëjnë kryesisht me saktësime të përcaktimeve në ligjin e mëparshëm. Po ashtu, ky ligj ndryshon afatin e zbatimit “Për shlyerjen e detyrimit të shërbimit të detyrueshëm ushtarak aktiv ose alternativ me pagesë” (nga 31 dhjetor 2010 ndryshon në 31 dhjetor 2009).

Kjo është dhe arsyeja që prej muajit shtator të vitit 2009, nuk vazhdon të kryhet rekrutimi i shtetasve për shërbimin e detyrueshëm ushtarak aktiv ose alternativ me pagesë.

60. Referuar detyrimit të personelit paqeruajtës për ndërgjegjësimin e autoriteteve vendase në kuadër të zbatimit të protokollit fakultativ, bëjmë me dije se deri më sot të gjitha kontingjentet shqiptarë të dërguara në misione paqeruajtëse kanë pasur misione me karakter të mirëfilltë ushtarak dhe jo trajnues. Misionet e këtyre trupave nuk përfshijnë probleme të monitorimit të zbatimit të protokollit kuadër dhe të Konventës “Për të drejtat e fëmijëve” në territorin shqiptar, pasi kjo është përgjegjësi e autoriteteve shtetërore vendase.

61. Të përcaktuara edhe në nenin 3 të ligjit nr. 8671, datë 26.10.2000 “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, strukturat kompetente shtetërore, përgjegjëse për zbatimin e protokollit kuadër dhe koordinimin mes tyre me autoritetet e varësisë, janë:

- Kuvendi, i cili miraton me ligj dokumentin e strategjisë së sigurimit, dokumentin e politikës së mbrojtjes, strategjisë ushtarake të RSH-së dhe ligjet e tjera në fushën e mbrojtjes e të Forcave të Armatosura.

- Presidenti i Republikës është Komandanti i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Në kohë paqeje ai e ushtron drejtimin e FA-së nëpërmjet Kryeministrit dhe Ministrit të Mbrojtjes, ndërsa në kohë lufte i drejton ato drejtpërsëdrejti ose nëpërmjet Komandantit të Forcave të Armatosura. Në rast sulmi të armatosur kundër Republikës së Shqipërisë, me kërkesë të Këshillit të Ministrave, ai shpall gjendjen e luftës.

- Këshilli i Ministrave ka për detyrë: a) përgatitjen dhe paraqitjen për miratim Kuvendit projektligjet për mbrojtjen, dokumentin e strategjisë së sigurimit dhe dokumentin e politikës së mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë, si dhe ligje të tjera për funksionimin efektiv të FA-së; b) i propozon Kuvendit ndryshime në numrin limit të personelit të FA-së; c) miraton, me propozim të Ministrit të Mbrojtjes, planin e mobilizimit të përgjithshëm për kohë lufte të burimeve njerëzore dhe atyre materiale, financiare të vendit; d) paraqet në Kuvend buxhetin e mbrojtjes dhe programet e veçanta financiare për FA-në për kohë paqeje dhe lufte; f) drejton veprimtarinë e organeve të pushtetit qendror dhe qarqeve, si dhe bashkërendon punën me organet e tjera të qeverisjes vendore për mobilizimin e pjesës së përgjithshme të FA dhe të burimeve për luftë; g) përcakton pagat dhe trajtimin ekonomik të personelit ushtarak dhe civil, që shërben në FA me propozim të Ministrit të Mbrojtjes; h) drejton dhe bashkëpunon me organet e qeverisjes vendore për rekrutimin e shtetasve, për kryerjen e shërbimit të detyrueshëm ushtarak, aktiv dhe në rezervë; i) organizon dhe drejton mbrojtjen civile të RSH-së dhe vendos krijimin dhe funksionimin e shtabeve të mbrojtjes pranë qarqeve, në të gjithë territorin; nxjerr akte nënligjore për mbrojtjen dhe FARSH; k) miraton programe të veçanta për pajisjen dhe modernizimin e Forcave të Armatosura;

- Ministri i Mbrojtjes përgjigjet para Kuvendit, Presidentit dhe Kryeministrit për zbatimin e politikës së mbrojtjes dhe strategjisë ushtarake;

- Shtabi i Përgjithshëm. Shtabi i Përgjithshëm përbën strukturën më të lartë ushtarake në FA dhe kryen komandën unike në to. Ai është përgjegjës për krijimin e një forcë luftarake të përbashkët e të njësuar, me forcat tokësore, detare dhe ajrore, të aftë për të plotësuar misionin e vet kushtetues;

- Komandantët e forcave (tokësore, detare dhe ajrore), komandimi dhe drejtimi i drejtpërdrejtë i forcave tokësore, detare e ajrore realizohet nga komandanti i secilës forcë. Komandimi dhe drejtimi i efektivave të komandës së mbështetjes logjistike dhe të komandës së doktrinave dhe të stërvitjes realizohen nga komandanti i komandës përkatëse.

VENDIM
Nr.875, datë 3.11.2010

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.1720, DATË 29.10.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KRITERET E PËRCAKTIMIT TË NIVELIT TË LARTË SPORTIV, PËR
MËNYRËN E SHPËRBLIMIT TË SPORTISTËVE, QË I ARRIJNË KËTO NIVELE, SI DHE
PËR PËRFITIMIN E TRAJTIMIT PËR PËRGATITJEN SPORTIVE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 26 të ligjit nr.9376, datë 21.4.2005 “Për sportin”, të ndryshuar, dhe të nenit 5 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 1.5 e vendimit nr.1720, datë 29.10.2008 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1.5 Sportistët e përcaktuar në pikën 1.1. të këtij kreu, përfitojnë të drejtën e studimit në Universitetin e Sporteve të Tiranës, pa konkurrim, dhe të drejtën e kryerjes së studimeve akademike, sipas një plani individual, të përcaktuar me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.”.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Universiteti i Sporteve të Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.876, datë 3.11.2010

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.78, DATË 8.2.2006 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN E MATURËS SHTETËRORE DHE PRANIMET NË
SHKOLLAT E LARTA PUBLIKE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 63 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.10247, datë 4.3.2010 “Për kornizën shqiptare të kualifikimeve”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.78, datë 8.2.2006 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Arsimi i mesëm quhet i përfunduar kur nxënësi arrin rezultate kaluese në provimet e detyruara dhe ato me zgjedhje. Në përfundim të provimeve të detyruara dhe të atyre me zgjedhje të Maturës Shtetërore, nxënësi pajiset me Diplomë të Maturës Shtetërore. Provimet e detyruara dhe ato me zgjedhje të Maturës Shtetërore zhvillohen në përfundim të vitit shkollor në një sesion të vetëm.”.

2. Pikat 3.1 dhe 3.2 shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.885, datë 3.11.2010

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.431, DATË 11.12.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË
PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË
PËRDORIM TË BASHKISË GRAMSH, TË QARKUT TË ELBASANIT”, DHE PËR NJË
NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.818, DATË 6.12.2006 “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË
INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË
PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË TATIMEVE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 7, 17 e 14/a të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e një shtese në listën përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, të bashkisë Gramsh, që i bashkëlidhet vendimit nr.431, datë 11.12.2007 të Këshillit të Ministrave, sipas lidhjes nr.1 dhe formularëve, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

Lista, që fillon me numrin rendor 501 (pesëqind e një) dhe përfundon me numrin rendor 503 (pesëqind e tre), ka gjithsej 2 (dy) fletë.

2. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, që i bashkëlidhet vendimit nr.818, datë 6.12.2006 të Këshillit të Ministrave, hiqen pronat “Dega e tatimeve (administratë)”, Gramsh, me sipërfaqe të përgjithshme 384 (treqind e tetëdhjetë e katër) m² dhe ndërtesë 200 (dyqind) m², dhe “Dega e tatimeve (garazh)”, Gramsh, me sipërfaqe të përgjithshme 66.9 (gjashtëdhjetë e gjashtë pikë nëntë) m² dhe ndërtesë 66.9 (gjashtëdhjetë e gjashtë pikë nëntë) m².

3. Në listën përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, të bashkisë Gramsh, të qarkut të Elbasanit që i bashkëlidhet vendimit nr.431, datë 11.12.2007 të Këshillit të Ministrave, hiqet prona me numër 239, truall i lirë, me numër pasurie 6/54 dhe me sipërfaqe 541.5 (pesëqind e dyzet e një pikë pesë) m².

4. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i pasurive të paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia Gramsh, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Gramsh	Lidhja nr.1	
Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
501, 502, 503	Prona që përdoren në fushën e administratës	Në pronësi

VENDIM
Nr.887, datë 3.11.2010

**PËR DISA SHITESA E NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.1146, DATË 5.8.2008 TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE “PËR HEQJEN E DISA NGA STRAVE NGA FONDI PYJOR DHE
KULLOSOR, QË DO TË PËRDOREN PËR VENDOSJEN E ANEMOMETRAVE TË
NËNSTACIONEVE, PËR INFRASTRUKTURËN LIDHËSE ELEKTRIKE, PËR
AEROGJENERATORËT, SHTYLLAT E TENSIONIT TË LARTË, SI DHE PËR RRUGËT
LIDHËSE ME AEROGJENERATORËT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “b” të pikës 1 të nenit 17 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar dhe të shkronjës “b” të pikës 1 të nenit 10 të ligjit nr.9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullor”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe të Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.1146, datë 5.8.2008 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Për sipërfaqet e fondit pyjor dhe kullor kombëtar, që do të përdoren nga shoqëria “Enpower Albania” sh.p.k., për ndërtimin e centralit të prodhimit të energjisë prej erës, të vepohet, si më poshtë vijon:

a) Të hiqen nga fondi pyjor dhe kullor kombëtar dhe të çregjistrohen nga zëri kadastral “Pyje dhe kullota” sipërfaqet që do të përdoren nga shoqëria “Enpower Albania” sh.p.k., për ndërtimin e themeleve mbajtëse të kullave të aerogjeneratorëve, nënstacioneve elektrike TM/TL 30 kV/220kV, kabinave nryje të komutimit TM/TM 30kV/30kV, themeleve mbajtëse të kullave vrojtuese anemometrike, si dhe shtyllat mbajtëse të linjës së tensionit të lartë, prej 10,664 (dhjetë presje gjashtëqind e gjashtëdhjetë e katër) hektarë fond kullor, që bëjnë pjesë në ekonominë kullorë: Karaburun, Dukat-Tragjas-Shashicë, Shashicë-Gumenicë, Ana e Detit, si dhe 0.563 (zero presje pesëqind e gjashtëdhjetë e tre) hektarë fond pyjor, që bëjnë pjesë në ekonominë pyjorë: Brinjat e Fushës-Karaburun, Kume-Shashicë, Ana e Detit-Palas, parku pyjor kombëtar Llogara, me sipërfaqe të përgjithshme 11,227 (njëmbëdhjetë presje dyqind e njëzet e shtatë) hektarë, sipas tabelës nr.1 dhe hartës përkatëse, bashkëlidhur këtij vendimi.

b) Të jepen në përdorim sipërfaqet e fondit pyjor dhe kullor kombëtar prej 24,093 (njëzet e katër presje zero nëntëdhjetë e tre) hektarë fond kullor dhe 1,302 (një presje treqind e dy) hektarë fond pyjor, që do të përdoren si sheshe të përkohshme për ndërtimin e objekteve, sipas tabelës nr.2 dhe hartës, bashkëlidhur këtij vendimi.

c) Të jepen në përdorim, sipas legjislacionit në fuqi, dhe të mbeten në fondin pyjor dhe kullor kombëtar sipërfaqet për ndërtimin e rrjetit rrugor rreth 134 (njëqind e tridhjetë e katër) km, i cili shtrihet në një sipërfaqe të përgjithshme prej 178,067 (njëqind e shtatëdhjetë e tetë presje zero gjashtëdhjetë e shtatë) hektarë, fond pyjor dhe kullor, sipas tabelës nr.3 dhe hartës bashkëlidhur këtij vendimi dhe të regjistrohen në kadastrën e fondit pyjor dhe kullor si “Infrastrukturë rrugore”.

2. Tabela nr.1 dhe nr.2, bashkëlidhur vendimit nr.1146, datë 5.8.2008 të Këshillit të Ministrave, zëvendësohen me tabelat 1, 2 dhe 3, si dhe me hartën bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Shoqëria “Enpower Albania, sh.p.k., duhet:

a) të përmirësojë 10,664 (dhjetë presje gjashtëqind e gjashtëdhjetë e katër) hektarë kullota, si dhe të pyllëzojë 0,563 (zero presje pesëqind e gjashtëdhjetë e tre) hektarë me pyje, brenda 2 (dy) viteve, nga fillimi i punimeve të ndërtimit të centralit, sipas ngastrave të përcaktuara nga drejtoria përkatëse e shërbimit pyjor.

b) të rehabilitojë dhe të rivegjetojë, brenda 2 (dy) viteve, pas përfundimit të ndërtimit të centralit të prodhimit të energjisë prej erës, sipërfaqet e lira, të cilat nuk do të jenë të përdorshme prej centralit elektrik me erë, gjithsej 25,395 (njëzet e pesë presje treqind e nëntëdhjetë e pesë) hektarë, (sipërfaqet e përdorura për sheshe të përkohshme të vendosjes së makinerive, gjatë ndërtimit të themeleve e kullave të aerogeneratorëve, anemometrave, shtyllat e tensionit të lartë, nënstationet elektrike, kabinat nyje të komutimit dhe gjithë komponentëve të tjerë të centralit elektrik).

c) të rehabilitojë, brenda 2 (dy) viteve, pas përfundimit të ndërtimit të infrastrukturës rrugore lidhëse e aerogeneratorëve me komponentët e centralit elektrik, një sipërfaqe të fondit pyjor dhe kullësor, të barabartë me atë që do të zërë ndërtimi i infrastrukturës së rrugëve lidhëse, sipas ngastrave të përcaktuara nga drejtoria përkatëse e shërbimit pyjor, si dhe të rehabilitojë të gjitha sipërfaqet e skarpateve të infrastrukturës rrugore që do të ndërtohet, duke i veshur ato me bimësi autoktone.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

TABELA NR. 1
SIPËRFAQET QË DO TË HIQEN NGA FONDI KOMBËTAR PYJOR DHE KULLËSOR,
TË INTERESUARA NGA “PARQET EOLIKE”

SIPËRFAQE FOND PYJOR					
Nr.	Ekonomia pyjore	Parcela nr.	Zëri kadastral	Sipërfaqja e zënë (hektarë)	Objekti
1	EP Brinjat e Fushës Karaburun	59 / a	pyll	0,0484	aerogeneratorë (themeli)
2	EP Brinjat e Fushës Karaburun	58 / c	pyll	0,0484	aerogeneratorë (themeli)
3	EP Brinjat e Fushës Karaburun	60	pyll	0,0484	aerogeneratorë (themeli)
4	EP Kume - Shashicë	26	pyll	0,0361	aerogeneratorë (themeli)
5	EP Parku Pyjor Llogara	19	kullotë	0,1452	aerogeneratorë (themeli)
6	EP Parku Pyjor Llogara	29 / a	kullotë	0,0484	aerogeneratorë (themeli)
7	EP Ana e Detit - Palas	17	pyll	0,0968	aerogeneratorë (themeli)
8	EP Ana e Detit - Palas	31 / a	pyll	0,0484	aerogeneratorë (themeli)
9	EP Kume - Shashicë	26	pyll	0,005	anemometer
10	EP Kume - Shashicë	26	pyll	0,009	kabina nyje
11	EP Parku Pyjor Llogara	19	pyll	0,009	kabina nyje
12	EP Kume - Shashicë	25	pyll	0,005	linjë e tensionit të lartë
13	EP Kume - Shashicë	26	pyll	0,01	linjë e tensionit të lartë
14	EP Brinjat e Fushës Karaburun	47 / b	kullotë	0,005	linjë e tensionit të lartë
Sipërfaqe totale ekonomi pyjore					
		(ha)		0,5631	

SIPËRFAQE FOND KULLSOR

Nr.	Ekonomia kullimore	Parcela nr.	Zëri kadastral	Sipërfaqja e zënë (hektarë)	Objekti
1	EK Karaburun	3	kullotë	0,0968	aerogjeneratorë (themeli)
2	EK Karaburun	4	kullotë	0,3388	aerogjeneratorë (themeli)
3	EK Karaburun	8	kullotë	0,0484	aerogjeneratorë (themeli)
4	EK Karaburun	9	kullotë	0,3872	aerogjeneratorë (themeli)
5	EK Karaburun	11	kullotë	0,1452	aerogjeneratorë (themeli)
6	EK Karaburun	12	kullotë	0,2904	aerogjeneratorë (themeli)
7	EK Karaburun	17	kullotë	0,1452	aerogjeneratorë (themeli)
8	EK Karaburun	20	kullotë	0,1452	aerogjeneratorë (themeli)
9	EK Karaburun	24	kullotë	0,3388	aerogjeneratorë (themeli)
10	EK Karaburun	26	kullotë	0,0484	aerogjeneratorë (themeli)
11	EK Dukat - Tragjas - Shashicë	40	kullotë	0,2888	aerogjeneratorë (themeli)
12	EK Dukat - Tragjas - Shashicë	41	kullotë	0,1083	aerogjeneratorë (themeli)
13	EK Dukat - Tragjas - Shashicë	49	kullotë	0,0722	aerogjeneratorë (themeli)
14	EK Dukat - Tragjas - Shashicë	51	kullotë	0,1083	aerogjeneratorë (themeli)
15	Ek Shashicë - Gumenicë	1	kullotë	0,0361	aerogjeneratorë (themeli)
16	Ek Shashicë - Gumenicë	3	kullotë	0,0722	aerogjeneratorë (themeli)
17	Ek Shashicë - Gumenicë	5	kullotë	0,0361	aerogjeneratorë (themeli)
18	Ek Shashicë - Gumenicë	6	kullotë	0,0361	aerogjeneratorë (themeli)
19	Ek Shashicë - Gumenicë	8	kullotë	0,2888	aerogjeneratorë (themeli)
20	Ek Shashicë - Gumenicë	9	kullotë	0,0722	aerogjeneratorë (themeli)
21	Ek Shashicë - Gumenicë	11	kullotë	0,1083	aerogjeneratorë (themeli)
22	Ek Shashicë - Gumenicë	12	kullotë	0,1083	aerogjeneratorë (themeli)
23	Ek Shashicë - Gumenicë	13	kullotë	0,2527	aerogjeneratorë (themeli)
24	Ek Shashicë - Gumenicë	14	kullotë	0,1083	aerogjeneratorë (themeli)
25	Ek Shashicë - Gumenicë	15	kullotë	0,1083	aerogjeneratorë (themeli)
26	Ek Shashicë - Gumenicë	16	kullotë	0,0361	aerogjeneratorë (themeli)
27	Ek Shashicë - Gumenicë	17	kullotë	0,1083	aerogjeneratorë (themeli)
28	Ek Shashicë - Gumenicë	19	kullotë	0,0722	aerogjeneratorë (themeli)
29	Ek Shashicë - Gumenicë	21	kullotë	0,0361	aerogjeneratorë (themeli)
30	Ek Shashicë - Gumenicë	30	kullotë	0,1444	aerogjeneratorë (themeli)
31	Ek Shashicë - Gumenicë	31	kullotë	0,0722	aerogjeneratorë (themeli)
32	Ek Shashicë - Gumenicë	33	kullotë	0,0722	aerogjeneratorë (themeli)
33	Ek Shashicë - Gumenicë	34	kullotë	0,0722	aerogjeneratorë (themeli)
34	Ek Shashicë - Gumenicë	36	kullotë	0,0722	aerogjeneratorë (themeli)
35	EK Ana e Detit	2	kullotë	0,3872	aerogjeneratorë (themeli)
36	EK Ana e Detit	3	kullotë	0,0484	aerogjeneratorë (themeli)
37	EK Ana e Detit	4	kullotë	0,3388	aerogjeneratorë (themeli)
38	EK Ana e Detit	5	kullotë	0,5324	aerogjeneratorë (themeli)
39	EK Ana e Detit	10	kullotë	0,484	aerogjeneratorë (themeli)
40	EK Ana e Detit	16	kullotë	0,5808	aerogjeneratorë (themeli)
41	EK Ana e Detit	17	kullotë	0,1936	aerogjeneratorë (themeli)
42	EK Ana e Detit	21	kullotë	0,2904	aerogjeneratorë (themeli)
43	EK Ana e Detit	22	kullotë	0,1452	aerogjeneratorë (themeli)
44	EK Ana e Detit	27	kullotë	0,1452	aerogjeneratorë (themeli)
45	EK Ana e Detit	30	kullotë	0,4356	aerogjeneratorë (themeli)
46	EK Karaburun	11	kullotë	0,005	anemometër
47	EK Karaburun	12	kullotë	0,005	anemometër
48	EK Karaburun	20	kullotë	0,005	anemometër
49	EK Karaburun	24	kullotë	0,005	anemometër
50	EK Dukat - Tragjas - Shashicë	40	kullotë	0,005	anemometër
51	EK Dukat - Tragjas - Shashicë	49	kullotë	0,005	anemometër

52	Ek Shashicë - Gumenicë	8	kullotë	0,005	anemometër
53	Ek Shashicë - Gumenicë	17	kullotë	0,005	anemometër
54	Ek Shashicë - Gumenicë	22	kullotë	0,005	anemometër
55	Ek Shashicë - Gumenicë	30	kullotë	0,005	anemometër
56	Ek Shashicë - Gumenicë	36	kullotë	0,005	anemometër
57	EK Ana e Detit	4	kullotë	0,005	anemometër
58	EK Ana e Detit	10	kullotë	0,005	anemometër
59	EK Ana e Detit	16	kullotë	0,005	anemometër
60	EK Ana e Detit	22	kullotë	0,005	anemometër
61	EK Ana e Detit	30	kullotë	0,005	anemometër
62	EK Karaburun	34	kullotë	0,6753	nënstacion elektrik
63	EK Karaburun	42	kullotë	0,9134	nënstacion elektrik
64	EK Dukat - Tragjas - Shashicë	49	kullotë	0,6838	nënstacion elektrik
65	EK Karaburun	4	kullotë	0,018	kabinë nyje
66	EK Karaburun	9	kullotë	0,009	kabinë nyje
67	EK Karaburun	24	kullotë	0,009	kabinë nyje
68	EK Dukat - Tragjas - Shashicë	41	kullotë	0,009	kabinë nyje
69	Ek Shashicë - Gumenicë	9	kullotë	0,009	kabinë nyje
70	Ek Shashicë - Gumenicë	13	kullotë	0,009	kabinë nyje
71	Ek Shashicë - Gumenicë	14	kullotë	0,009	kabinë nyje
72	EK Ana e Detit	2	kullotë	0,009	kabinë nyje
73	EK Ana e Detit	5	kullotë	0,018	kabinë nyje
74	EK Ana e Detit	16	kullotë	0,009	kabinë nyje
75	EK Ana e Detit	17	kullotë	0,009	kabinë nyje
76	EK Ana e Detit	21	kullotë	0,009	kabinë nyje
77	EK Ana e Detit	27	kullote	0,009	kabinë nyje
78	EK Karaburun	34	kullotë	0,005	linjë e tensionit të lartë
79	EK Karaburun	37	kullotë	0,005	linjë e tensionit të lartë
80	EK Karaburun	38	kullotë	0,005	linjë e tensionit të lartë
81	EK Karaburun	39	kullotë	0,005	linjë e tensionit të lartë
82	EK Karaburun	40	kullotë	0,01	linjë e tensionit të lartë
83	EK Karaburun	41	kullotë	0,005	linjë e tensionit të lartë
84	EK Karaburun	42	kullotë	0,03	linjë e tensionit të lartë
85	EK Dukat - Tragjas - Shashicë	46	kullotë	0,01	linjë e tensionit të lartë
86	EK Dukat - Tragjas - Shashicë	47	kullotë	0,01	linjë e tensionit të lartë
87	EK Dukat - Tragjas - Shashicë	48	kullotë	0,01	linjë e tensionit të lartë
88	EK Dukat - Tragjas - Shashicë	49	kullotë	0,015	linjë e tensionit të lartë
89	EK Dukat - Tragjas - Shashicë	51	kullotë	0,01	linjë e tensionit të lartë

	Sipërfaqe totale ekonomi kullimore	(ha)		10,6644
	Sipërfaqe totale, pyjore + kullimore	(ha)		11,2275

TABELA NR. 2
SIPËRFAQET E NEVOJSHME PËR SHESHET E PËRKOJSHME PËR NDËRTIMIN E
OBJEKTEVE TË CENTRALEVE

SIPËRFAQE TE FONDIT PYJORE					
Nr.	Ekonomia pyjore	Parcela nr.	Zëri kadastral	Sipërfaqja e zënë (hektarë)	Objekti
1	EP Brinjat e Fushës Karaburun	30 / c	pyll	0,0305	shesh përdorim i përkohshëm
2	EP Brinjat e Fushës Karaburun	59 / a	pyll	0,0113	shesh përdorim i përkohshëm
3	EP Brinjat e Fushës Karaburun	58 / c	pyll	0,1266	shesh përdorim i përkohshëm
4	EP Brinjat e Fushës Karaburun	60	pyll	0,1266	shesh përdorim i përkohshëm
5	EP Kume - Shashicë	26	pyll	0,1299	shesh përdorim i përkohshëm
6	EP Parku Pyjor Llogara	19	kullotë	0,3708	shesh përdorim i përkohshëm
7	EP Parku Pyjor Llogara	29 / a	kullotë	0,1266	shesh përdorim i përkohshëm
8	EP Ana e Detit - Palas	17	pyll	0,2532	shesh përdorim i përkohshëm
9	EP Ana e Detit - Palas	31 / a	pyll	0,1266	shesh përdorim i përkohshëm
Sipërfaqe totale ekonomi pyjore		(ha)		1,3021	

SIPËRFAQE TË FONDIT KULLOSORE					
Nr.	Ekonomia kullimore	Parcela nr.	Zëri kadastral	Sipërfaqja e zënë (hektarë)	Objekti
1	EK Karaburun	1 / B	kullotë	0,0942	shesh përdorim i përkohshëm
2	EK Karaburun	3	kullotë	0,2198	shesh përdorim i përkohshëm
3	EK Karaburun	4	kullotë	0,8682	shesh përdorim i përkohshëm
4	EK Karaburun	8	kullotë	0,1266	shesh përdorim i përkohshëm
5	EK Karaburun	9	kullotë	1,0038	shesh përdorim i përkohshëm
6	EK Karaburun	11	kullotë	0,3798	shesh përdorim i përkohshëm
7	EK Karaburun	12	kullotë	0,7596	shesh përdorim i përkohshëm
8	EK Karaburun	17	kullotë	0,3798	shesh përdorim i përkohshëm
9	EK Karaburun	20	kullotë	0,4553	shesh përdorim i përkohshëm
10	EK Karaburun	24	kullotë	0,9033	shesh përdorim i përkohshëm
11	EK Karaburun	26	kullotë	0,0795	shesh përdorim i përkohshëm
12	EK Dukat - Tragjas - Shashicë	40	kullotë	1,1112	shesh përdorim i përkohshëm
13	EK Dukat - Tragjas - Shashicë	41	kullotë	0,4077	shesh përdorim i përkohshëm
14	EK Dukat - Tragjas - Shashicë	49	kullotë	0,2778	shesh përdorim i përkohshëm
15	EK Dukat - Tragjas - Shashicë	51	kullotë	0,4167	shesh përdorim i përkohshëm
16	Ek Shashicë - Gumenicë	1	kullotë	0,1389	shesh përdorim i përkohshëm
17	Ek Shashicë - Gumenicë	3	kullotë	0,219	shesh përdorim i përkohshëm
18	Ek Shashicë - Gumenicë	4	kullotë	0,0588	shesh përdorim i përkohshëm
19	Ek Shashicë - Gumenicë	5	kullotë	0,1389	shesh përdorim i përkohshëm
20	Ek Shashicë - Gumenicë	6	kullotë	0,1389	shesh përdorim i përkohshëm
21	Ek Shashicë - Gumenicë	8	kullotë	1,1112	shesh përdorim i përkohshëm
22	Ek Shashicë - Gumenicë	9	kullotë	0,2688	shesh përdorim i përkohshëm
23	Ek Shashicë - Gumenicë	11	kullotë	0,4167	shesh përdorim i përkohshëm
24	Ek Shashicë - Gumenicë	12	kullotë	0,4167	shesh përdorim i përkohshëm
25	Ek Shashicë - Gumenicë	13	kullotë	0,9633	shesh përdorim i përkohshëm
26	Ek Shashicë - Gumenicë	14	kullotë	0,4077	shesh përdorim i përkohshëm
27	Ek Shashicë - Gumenicë	15	kullotë	0,4294	shesh përdorim i përkohshëm
28	Ek Shashicë - Gumenicë	16	kullotë	0,1389	shesh përdorim i përkohshëm

29	Ek Shashicë - Gumenicë	17	kullotë	0,4167	shesh përdorim i përkohshëm
30	Ek Shashicë - Gumenicë	19	kullotë	0,2651	shesh përdorim i përkohshëm
31	Ek Shashicë - Gumenicë	21	kullotë	0,1389	shesh përdorim i përkohshëm
32	Ek Shashicë - Gumenicë	30	kullotë	0,5556	shesh përdorim i përkohshëm
33	Ek Shashicë - Gumenicë	31	kullotë	0,2778	shesh përdorim i përkohshëm
34	Ek Shashicë - Gumenicë	33	kullotë	0,2778	shesh përdorim i përkohshëm
35	Ek Shashicë - Gumenicë	34	kullotë	0,2778	shesh përdorim i përkohshëm
36	Ek Shashicë - Gumenicë	36	kullotë	0,2778	shesh përdorim i përkohshëm
37	EK ana e Detit	2	kullotë	1,0038	shesh përdorim i përkohshëm
38	EK Ana e Detit	3	kullotë	0,1096	shesh përdorim i përkohshëm
39	EK Ana e Detit	4	kullotë	0,9032	shesh përdorim i përkohshëm
40	EK Ana e Detit	5	kullotë	1,3746	shesh përdorim i përkohshëm
41	EK Ana e Detit	10	kullotë	1,2776	shesh përdorim i përkohshëm
42	EK Ana e Detit	16	kullotë	1,4681	shesh përdorim i përkohshëm
43	EK Ana e Detit	17	kullotë	0,4974	shesh përdorim i përkohshëm
44	EK Ana e Detit	21	kullotë	0,7416	shesh përdorim i përkohshëm
45	EK Ana e Detit	22	kullotë	0,3888	shesh përdorim i përkohshëm
46	EK Ana e Detit	27	kullotë	0,3708	shesh përdorim i përkohshëm
47	EK Ana e Detit	30	kullotë	1,1394	shesh përdorim i përkohshëm

	Sipërfaqe totale ekonomi kullimore	(ha)		24,0929
	Sipërfaqe totale pyjore + kullimore	(ha)		25,3950


TABELA NR.3
SIPËRFAQET E NEVOJSHME QË DO TË PËRDOREN PËR NDËRTIMIN E INFRASTRUKTURËS RRUGORE

SIPËRFAQE TE FONDIT PYJOR					
Nr.	Ekonomia pyjore	Parcela nr.	Zëri kadastral	Sipërfaqja e zënë (hektarë)	Objekti
1	EP Kume - Shashicë	25	pyll	1,1006	infrastrukturë rrugore
2	EP Kume - Shashicë	25	pyll	0,3332	infrastrukturë rrugore
3	EP Kume - Shashicë	26	pyll	0,4539	infrastrukturë rrugore
4	EP Parku Pyjor Llogara	19	kullotë	1,0967	infrastrukturë rrugore
5	EP Parku Pyjor Llogara	29 / a	kullotë	0,9696	infrastrukturë rrugore
6	EP Ana e Detit - Palas	17	pyll	0,5284	infrastrukturë rrugore
7	EP Ana e Detit - Palas	31 / a	pyll	0,6157	infrastrukturë rrugore
8	EP Brinjat e fushës Karaburun	28	kullotë	0,0262	infrastrukturë rrugore
9	EP Brinjat e fushës Karaburun	29 / c	Kullotë	0,0169	infrastrukturë rrugore
10	EP Brinjat e fushës Karaburun	30 / c	Kullotë	0,2352	infrastrukturë rrugore
11	EP Brinjat e fushës Karaburun	46	kullotë	0,633	infrastrukturë rrugore
12	EP Brinjat e fushës Karaburun	55	pyll	0,5031	infrastrukturë rrugore
13	EP Brinjat e fushës Karaburun	59 / a	pyll	1,956	infrastrukturë rrugore
14	EP Brinjat e fushës Karaburun	58 / c	pyll	0,3083	infrastrukturë rrugore
15	EP Brinjat e fushës Karaburun	60	pyll	0,7816	infrastrukturë rrugore
16	EP Brinjat e fushës Karaburun	75	pyll	0,2387	infrastrukturë rrugore
17	EP Ana e Detit - Palas	66	pyll	0,9177	infrastrukturë rrugore
	Sipërfaqe totale, ekonomi pyjore	(ha)		10,7148	

SIPËRFAQE TË FONDIT KULLOSOR					
Nr.	Ekonomia kullimore	Parcela nr.	Zëri kadastral	Sipërfaqja e zënë (hektarë)	Objekti
1	EK Karaburun	1 / b	kullotë	0,0259	infrastrukturë rrugore
2	EK Karaburun	3	kullotë	0,9882	infrastrukturë rrugore
3	EK Karaburun	4	kullotë	3,5554	infrastrukturë rrugore
4	EK Karaburun	8	kullotë	0,4585	infrastrukturë rrugore
5	EK Karaburun	9	kullotë	5,6095	infrastrukturë rrugore
6	EK Karaburun	11	kullotë	1,0673	infrastrukturë rrugore
7	EK Karaburun	12	kullotë	3,3207	infrastrukturë rrugore
8	EK Karaburun	17	kullotë	1,0776	infrastrukturë rrugore
9	EK Karaburun	20	kullotë	1,9537	infrastrukturë rrugore
10	EK Karaburun	24	kullotë	7,4442	infrastrukturë rrugore
11	EK Karaburun	25	kullotë	0,6422	infrastrukturë rrugore
12	EK Karaburun	26	kullotë	0,9082	infrastrukturë rrugore
13	EK Karaburun	29	kullotë	1,6837	infrastrukturë rrugore
14	EK Karaburun	30	kullotë	1,3385	infrastrukturë rrugore
15	EK Karaburun	31	kullotë	0,8999	infrastrukturë rrugore
16	EK Karaburun	33	kullotë	0,997	infrastrukturë rrugore
17	EK Karaburun	34	kullotë	1,6419	infrastrukturë rrugore
18	EK Karaburun	35	kullotë	3,5005	infrastrukturë rrugore
19	EK Karaburun	38	kullotë	0,0647	infrastrukturë rrugore
20	EK Karaburun	40	kullotë	1,7831	infrastrukturë rrugore
21	EK Karaburun	41	kullotë	5,723	infrastrukturë rrugore
22	EK Karaburun	42	kullotë	2,4106	infrastrukturë rrugore
23	EK Dukat - Tragjas - Shashicë	40	kullotë	8,7071	infrastrukturë rrugore
24	EK Dukat - Tragjas - Shashicë	41	kullotë	4,9669	infrastrukturë rrugore
25	EK Dukat - Tragjas - Shashicë	49	kullotë	1,5246	infrastrukturë rrugore
26	EK Dukat - Tragjas - Shashicë	51	kullotë	6,0211	infrastrukturë rrugore
27	Ek Shashicë - Gumenicë	1	kullotë	1,5646	infrastrukturë rrugore
28	Ek Shashicë - Gumenicë	2	kullotë	0,1042	infrastrukturë rrugore
29	Ek Shashicë - Gumenicë	3	kullotë	1,467	infrastrukturë rrugore
30	Ek Shashicë - Gumenicë	4	kullotë	3,3748	infrastrukturë rrugore
31	Ek Shashicë - Gumenicë	5	kullotë	0,2534	infrastrukturë rrugore
32	Ek Shashicë - Gumenicë	6	kullotë	0,4187	infrastrukturë rrugore
33	Ek Shashicë - Gumenicë	8	kullotë	7,9813	infrastrukturë rrugore
34	Ek Shashicë - Gumenicë	9	kullotë	1,953	infrastrukturë rrugore
35	Ek Shashicë - Gumenicë	11	kullotë	2,2333	infrastrukturë rrugore
36	Ek Shashicë - Gumenicë	12	kullotë	1,5785	infrastrukturë rrugore
37	Ek Shashicë - Gumenicë	13	kullotë	3,6064	infrastrukturë rrugore
38	Ek Shashicë - Gumenicë	14	kullotë	2,0576	infrastrukturë rrugore
39	Ek Shashicë - Gumenicë	15	kullotë	2,1696	infrastrukturë rrugore

40	Ek Shashicë - Gumenicë	16	kullotë	0,2916	infrastrukturë rrugore
41	Ek Shashicë - Gumenicë	17	kullotë	4,0123	infrastrukturë rrugore
42	Ek Shashicë - Gumenicë	19	kullotë	0,9955	infrastrukturë rrugore
43	Ek Shashicë - Gumenicë	21	kullotë	0,2143	infrastrukturë rrugore
44	Ek Shashicë - Gumenicë	30	kullotë	6,2746	infrastrukturë rrugore
45	Ek Shashicë - Gumenicë	31	kullotë	0,9656	infrastrukturë rrugore
46	Ek Shashicë - Gumenicë	33	kullotë	4,1868	infrastrukturë rrugore
47	Ek Shashicë - Gumenicë	34	kullotë	5,7336	infrastrukturë rrugore
48	Ek Shashicë - Gumenicë	36	kullotë	1,8278	infrastrukturë rrugore
49	EK Ana e Detit	2	kullotë	9,2872	infrastrukturë rrugore
50	EK Ana e Detit	3	kullotë	0,2258	infrastrukturë rrugore
51	EK Ana e Detit	4	kullotë	3,544	infrastrukturë rrugore
52	EK Ana e Detit	5	kullotë	5,7688	infrastrukturë rrugore
53	EK Ana e Detit	10	kullotë	4,3705	infrastrukturë rrugore
54	EK Ana e Detit	16	kullotë	5,1905	infrastrukturë rrugore
55	EK Ana e Detit	17	kullotë	2,5569	infrastrukturë rrugore
56	EK Ana e Detit	21	kullotë	3,329	infrastrukturë rrugore
57	EK Ana e Detit	22	kullotë	4,278	infrastrukturë rrugore
58	EK Ana e Detit	27	kullotë	3,1258	infrastrukturë rrugore
59	EK Ana e Detit	30	kullotë	4,0977	infrastrukturë rrugore

	Sipërfaqe totale, ekonomi kullimore		(ha)		167,3527
	Sipërfaqe totale pyjore + kullimore		(ha)		178,0675



MINISTRIA E MJEDISIT, PYEJEVE DHE ADMINISTRIMIT TE UJERAVE	
Drejtoria e Sherbimit Pjgor, VLORE	
KUADRI I BASHKIMIT TE EKSPLOATIMEVE	Shkalla 1:25000
Drejtues: Agim MUSA	Shkurti 2010
Pune: Inj. Avetis QUCAJ	

VENDIM
Nr.888, datë 3.11.2010

PËR EMËRIMIN E ANËTARËVE TË BORDIT DREJTUES TË AGJENCISË SHQIPTARE TË ZHVILLIMIT TË INVESTIMEVE, TË PËRZGJEDHUR NGA SEKTORI EKONOMIK PRIVAT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 12, pikat 1 e 3, e 18 të ligjit nr.10 303, datë 15.7.2010 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Emërimin e anëtarëve të bordit drejtues të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, të përzgjedhur nga sektori ekonomik privat, si më poshtë vijon:

a) Z.Seyhan Pencapligil, Drejtor Ekzekutiv i Bankës Kombëtare Tregtare dhe anëtar i Shoqatës Shqiptare të Bankave;

b) Z.Edmond Leka, president i Union Banks dhe anëtar i Shoqatës Shqiptare të Bankave;

c) Z.Gjergj Gjika, Kryetar i Dhomës së Fasonistëve të Shqipërisë dhe anëtar i Këshillit Konsultativ të Biznesit;

ç) Z.Avni Ponari, Drejtor i Përgjithshëm i Kompanisë “Sigal” dhe kryetar i Shoqatës së Siguruesve të Shqipërisë.

2. Ngarkohet Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.889, datë 11.11.2010

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.591, DATË 23.7.2010 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR DISIPLINIMIN E PËRDORIMIT TË FONDEVE BUXHETORE”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimit publik”, të ndryshuar, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në fund të shkronjës “dh” të pikës 1 të vendimit nr.591, datë 23.7.2010 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohen paragrafët me këtë përmbajtje:

“Përjashtimisht, lejohet Ministria e Brendshme, Garda e Republikës si autoritet kontraktor, të vijojë normalisht procedurat e prokurimit, përfshirë edhe lidhjen e kontratës, përkatësisht, për objektet e mëposhtme:

i) Blerje gomash, me fond limit 1 250 000 (një milion e dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

ii) Blerje materialesh të imëta për telekomunikacionin dhe elektronikën, me fond limit 833 333 (tetëqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë.

iii) Blerje materialesh për ndriçim, ngrohje, dezinfektim, me fond limit 583 333 (pesëqind e tetëdhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.890, datë 12.11.2010

PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NË BUXHETIN E VITIT 2010, MIRATUAR PËR
MINISTRINË E MBROJTJES

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 16 të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Rishpërndarjen e fondeve ndërmjet programeve në buxhetin e vitit 2010, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes, si më poshtë vijon:

a) Në programin “Planifikim, menaxhim dhe administrim” të shtohet fondi 88 000 000 (tetëdhjetë e tetë milionë) lekë, për shpenzimet korente.

b) Në programin “Mbështetje luftimi” të shtohet fondi 25 000 000 (njëzet e pesë milionë) lekë, për shpenzimet korente.

c) Në programin “Mbështetje e përqendruar” të shtohet fondi 11 000 000 (njëmbëdhjetë milionë) lekë, për shpenzimet korente.

ç) Në programin “Bashkëpunimi civilo-ushtarak” të shtohet fondi 32 000 000 (tridhjetë e dy milion) lekë, për shpenzimet korente.

d) Në programin “Mbështetje shëndetësore” të shtohet fondi 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekë, për shpenzimet korente.

dh) Në programin “Forcat e luftimit” të pakësohet fondi 171 000 000 (njëqind e shtatëdhjetë e një milionë) lekë, në shpenzimet korente.

2. Ngarkohen Ministri i Financave dhe Ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.891, datë 10.11.2010

PËR PËRCAKTIMIN E LISTËS SË STANDARDEVE TË HARMONIZUARA SHQIPTARE, QË
KANË KARAKTER REFERUES PËR PREZUMIMIN E SIGURISË TË PRODUKTEVE PËR
KONSUMATORIN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, pika 19, e 5 të ligjit nr.9779, datë 16.7.2007 “Për sigurinë e përgjithshme, kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të produkteve joushqimore”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministrit i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e standardeve të harmonizuara shqiptare, që kanë karakter referues për prezumimin e sigurisë të produkteve për konsumatorin, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Standardet e harmonizuara shqiptare, numrat dhe titujt e të cilave janë përfshirë në listën e përmendur në pikën 1 të këtij vendimi, shërbejnë si dokumente reference për prezumimin e sigurisë të produkteve për konsumatorin, në përputhje me kërkesat e sigurisë së përgjithshme, të përcaktuara në ligjin nr.9779, datë 16.7.2007.

3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LISTA E STANDARDEVE TË HARMONIZUARA SHQIPTARE QË KANË KARAKTER REFERUES PËR PREZUMIMIN E SIGURISË SË PRODUKTEVE PËR KONSUMATORIN, SIPAS LIGJIT NR.9779, DATË 16.7.2007 “PËR SIGURINË E PËRGJITHSHME, KËRKESAT THELBËSORE DHE VLERËSIMIN E KONFORMITETIT TË PRODUKTEVE JOUSHQIMORE

Nr.	Referenca dhe titulli i standardit të harmonizuar	Viti i adoptimit si standard shqiptar SSH	Mënyra e adoptimit (me faqe të parë, Fp, ose me përkthim të plotë Pp)
1	S SH EN 581-1:2006 Orendi për përdorim të jashtëm – Ndenjëse dhe tavolina për piknik, për përdorim shtëpiak dhe kontraktual – Pjesa 1: Kërkesat e përgjithshme	2007	Fp
2	S SH EN 913:2008 Pajisje gjimnastikore – Kërkesat e përgjithshme për sigurinë dhe metodat e provës	2008	Fp
3	S SH EN 916:2003 Pajisje gjimnastikore –Vendet e kërcimit – Kërkesat dhe metodat e provave përfshirë sigurinë	2004	Fp
4	S SH EN 957-1:2005 Pajisje trajnimi – Pjesa 1: Kërkesat e përgjithshme të sigurisë dhe metodat e provës	2007	Fp
5	S SH EN 957-2:2003 Pajisje trajnimi — Pjesa 2: Pajisje trajnimi për forcën, kërkesat specifike për sigurinë dhe metodat shtesë të provës	2004	Fp
6	S SH EN 957-4:2006+A1:2010 Pajisje trajnimi — Pjesa 4: Stola trajnimi për forcën, kërkesat specifike për sigurinë dhe metodat shtesë të provës	2010	Fp
7	S SH EN 957-5:2009 Pajisje trajnimi — Pjesa 5: Pajisje trajnimi me pedale me kthesa, kërkesat specifike për sigurinë dhe metodat shtesë të provës	2010	Fp
8	S SH EN 957-6: 2001 Pajisje trajnimi — Pjesa 6: Shkallët lëvizëse, kërkesat specifike për sigurinë dhe metodat shtesë të provës	2004	Fp
9	S SHsEN 957-7:1998 Pajisje trajnimi — Pjesa 7: Makinat vozitëse, kërkesat specifike për sigurinë dhe metodat shtesë të provës	2004	Fp
10	S SH EN 957-8:1998 Pajisje trajnimi — Pjesa 8: Shkallët, shkallinat e ngjitjes dhe shkallët e ngjitjes - Kërkesat specifike për sigurinë dhe metodat shtesë të provës	2004	Fp

11	S SH EN 957-9:2003 Pajisje trajnimi — Pjesa 9: Trajnuesit eliptikë, kërkesat specifike për sigurinë dhe metodat shtesë të provës	2005	Fp
12	S SH EN 957-10:2005 Pajisje trajnimi e fiksuar në një vend — Pjesa 10: Biçikleta ushtrimore me një rrotë të fiksuar ose pa rrotë të lirë, kërkesat specifike të sigurisë dhe metodat shtesë të provës	2007	Fp
13	S SH EN 1129-1:1995 Mobilie — Krevatat që palosen — Kërkesat e sigurisë dhe prova — Pjesa 1: Kërkesat e sigurisë	2007	Fp
14	S SH EN 1129-2:1995 Mobilie — Krevatat që palosen — Kërkesat e sigurisë dhe prova — Pjesa 2: Metodatat e provës	2007	Fp
15	S SH EN 1130-1:1996 Mobilie — Krevate për fëmijë dhe djepe për përdorim shtëpiak — Pjesa 1: Kërkesat e sigurisë	2003	Fp
16	S SH EN 1130-2:1996 Mobilie — Krevate për fëmijë dhe djepe për përdorim shtëpiak — Pjesa 2: Metodatat e provës	2003	Fp
17	S SH EN 1400-1:2002 Artikuj që përdoren për mirërritjen e fëmijëve — Biberonë për bebe dhe fëmijë të vegjël — Pjesa 1: Kërkesa të përgjithshme të sigurisë dhe informacioni i produktit	2005	Fp
18	S SH EN 1400-2:2002 Artikuj që përdoren për mirërritjen e fëmijëve — Biberonë për bebe dhe fëmijë të vegjël — Pjesa 2: Kërkesat mekanike dhe provat	2005	Fp
19	S SH EN 1400-3:2002 Artikuj që përdoren për mirërritjen e fëmijëve — Biberonë për bebe dhe fëmijë të vegjël — Pjesa 3: Kërkesat kimike dhe provat	2005	Fp
20	S SH EN 1466:2004+A1:2007 Artikuj për kujdesin e fëmijëve — Mbajtëse portative dhe mbështetëse — Kërkesat e sigurisë dhe metodat e provave	2010	Fp
21	S SH EN 1651:1999 Pajisje e fluturimit me rrëshqitje — Pajimet e lidhjeve — Kërkesat e sigurisë dhe provat e qëndrueshmërisë	2007	Fp
22	S SH EN 1860-1:2003 Pajisjet, lëndët djegëse të ngurta dhe ndezësit për <i>barbeky</i> (pjekje në zgarë) — Pjesa 1: Lëndët djegëse të ngurta për <i>barbeky</i> — Kërkesat dhe metodat e provës	2005	Fp
	S SH EN 1860-1:2003/A1:2006	2010	
23	S SH EN ISO 9994:2006 Ndezësit — Specifikimi për sigurinë (ISO 9994:2005)	2007	Fp
	S SH EN ISO 9994:2006/A1 :2008	2010	
24	S SH EN 12196:2003 Pajisje gjimnastikore — Kaluçët dhe pedanat — Funkionimi dhe kërkesat e sigurisë, metodat e provës	2005	Fp
25	S SH EN 12197:1997 Pajisje gjimnastikore — Shufrat horizontale — Kërkesat e sigurisë, metodat e provës	2005	Fp
26	S SH EN 12346:1998 Pajisje gjimnastikore — Shufrat e murit, shkallët e murit dhe kornizat e ngjitjes — Kërkesat e sigurisë, metodat e provës	2005	Fp
27	S SH EN 12432:1998 Pajisje gjimnastikore — Trarët balancues - Funkionimi dhe kërkesat e sigurisë, metodat e provës	2005	Fp
28	S SH EN 12491 :2001 Pajisje fluturimi me rrëshqitje — Parashutat e ndihmës kritike — Kërkesat e sigurisë dhe metodat e provës	2007	Fp

29	S SH EN 12586:2007 Artikuj të kujdesit për fëmijët — Mbajtëse biberoni — Kërkesat e sigurisë dhe metodat e provës	2008	Fp
30	S SH EN 12655:1998 Pajisje gjimnastikore — Unazat mbajtëse - Funkionimi dhe kërkesat e sigurisë, metodat e provës	2005	Fp
31	S SH EN 13138-2:2007 Mjete ndihmëse pluskuese për instruksion për notim — Pjesa 2: Kërkesat e sigurisë dhe metodat e provës për mjetet ndihmëse pluskuese që duhet të mbahen	2010	Fp
32	S SH EN 13209-1:2004 Artikuj të përdorimit dhe të kujdesit për fëmijët — Mbajtëse për fëmijë — Kërkesat e sigurisë dhe metodat e provës — Pjesa 1: Mbajtëset e shpinës në formë kuadrati	2007	Fp
33	S SH EN 13319:2000 Pajisjet zhytëse — Matësit e thellësisë dhe pajisjet e kombinuara për matjen e thellësisë dhe të kohës — Funkionimi dhe kërkesat e sigurisë, metodat e provës	2005	Fp
34	S SH EN 13899:2003 Pajisje sportive me rrota të vogla — Patina me rrota — Kërkesat e sigurisë dhe metodat e provave	2007	Fp
35	S SH EN 14059:2002 Llambat dekorative me vaj — Kërkesat e sigurisë dhe metodat e provës	2005	Fp
36	S SH EN 14344:2004 Artikuj të përdorimit dhe të kujdesit për fëmijët — Ndenjëse të fëmijëve për biçikleta — Kërkesat e sigurisë dhe metodat e provës	2007	Fp
37	S SH EN 14350-1:2004 Artikuj të përdorimit dhe të kujdesit për fëmijët — Pajisje për të pirë — Pjesa 1: Kërkesat e përgjithshme dhe kërkesat mekanike dhe metodat e provës	2007	Fp
38	S SH EN 14682:2007 Siguria e veshjeve për fëmijë — Kordonët dhe zinxhirët tendosës në veshjet e fëmijëve - Specifikimet	2007	Fp
39	S SH EN 14764:2005 Biçikleta për qytet dhe udhëtim – Kërkesat e sigurisë dhe metodat e provës	2007	Fp
40	S SH EN 14766:2005 Biçikleta për në mal – Kërkesat e sigurisë dhe metodat e provës	2007	Fp
41	SSHEN14781:2005 Biçikletat e shpejta – Kërkesat e sigurisë dhe metodat e provës	2007	Fp
42	S SH EN 14872:2006 Biçikletat — Aksesorët për biçikletat — Transportuese bagazhi	2007	Fp
43	S SH EN 1273:2005 Artikuj të përdorimit dhe të kujdesit për fëmijët - Rrethore (kuadrate) për të ecur fëmijët – Kërkesat e sigurisë dhe metodat e provës	2007	Fp
44	S SH EN 14872:2006 Biçikletat — Aksesorët për biçikletat — Transportuese bagazhi	2007	Fp

VENDIM
Nr.892, datë 10.11.2010

PËR RISHPËRNDARJE FONDI LIMIT, BRENDA BUXHETIT TË MIRATUAR PËR VITIN 2010, NGA MINISTRIA E MBROJTJES, NË MINISTRINË E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGETIKËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 16 të ligjit nr.10 190, datë 27.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Rishpërndarjen e një fondi limit, brenda buxhetit të miratuar për vitin 2010, si më poshtë vijon:

a) Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në programin “Mbështetje për burimet natyrore”, për Shërbimin Gjeologjik Shqiptar, në zërin “Shpenzime operative”, t’i shtohet fondi limit nga të ardhurat kapitulli 5, prej 2 000 000 (dy milionë) lekësh;

b) Ministrisë së Mbrojtjes, në programin “Forcat e luftimit”, kapitulli 5, t’i pakësohet fondi limit nga të ardhurat, prej 2 000 000 (dy milionë) lekësh.

2. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.893, datë 10.11.2010

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.591, DATË 23.7.2010 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR DISIPLINIMIN E PËRDORIMIT TË FONDEVE BUXHETORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në fund të shkronjës “dh” të pikës 1 të vendimin nr.591, datë 23.7.2010 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohen paragrafët me këtë përmbajtje:

“Përfundimisht, lejohet Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, si autoritet kontraktor, të kryejë procedurat e prokurimit, me fondet e miratuara në buxhetin e vitit 2010, për blerjen e materialeve të kazermimit dhe për të lidhur kontratën përkatëse, si dhe të vijojë normalisht procedurat e zbatimit të kontratës të blerjes së vajit ushqimor.

Përfundimisht, lejohet Ministria e Punëve Publike dhe Transporteve, drejtoritë rajonale rrugore përkatëse, si autoritete kontraktore, të vijojnë normalisht procedurat e prokurimit për objektet sipas aneksit nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Përfundimisht, lejohet Ministria e Brendshme, drejtoritë e policive në qarqe dhe njësitë e tjera, si autoritete kontraktore, të vijojnë normalisht procedurat e prokurimit, përkatësisht, për objektet e mëposhtme:

i) Drejtoria e Policisë së Qarkut Berat, për “Blerje pjesësh këmbimi”, me fond limit prej 1 718 000 (një milion e shtatëqind e tetëmbëdhjetë mijë) lekë.

ii) Drejtoria e Policisë së Qarkut Gjirokastrë, për “Mirëmbajtjen e mjeteve të transportit”, me fond limit 1 000 000 (një milion) lekë.

iii) Drejtoria e Policisë së Qarkut Korçë, për “Blerje pjesësh këmbimi”, me fond limit 1 242 000 (një milionë e dyqind e dyzet e dy mijë) lekë.

iv) Delta Forcë, Vlorë, për “Blerje ushqimi”, me fond limit 1 560 000 (një milion e pesëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë.

v) Drejtoria e Policisë së Qarkut Dibër, për “Blerje pjesësh këmbimi”, me fond limit 2 900 000 (dy milionë e nëntëqind mijë) lekë.

vi) Instituti i përgatitjes së qenve të policisë, Tiranë, për “Blerje ushqimi”, me fond limit 636 000 (gjashtëqind e tridhjetë e gjashtë mijë) lekë.

vii) Drejtoria e Policisë së Qarkut Shkodër, për “Blerje pjesësh këmbimi”, me fond limit 1 600 000 (një milion e gjashtëqind mijë) lekë dhe për “Mirëmbajtjen e mjeteve të transportit”, me fond limit 1 550 000 (një milion e pesëqind e pesëdhjetë mijë) lekë”.

viii) Drejtoria e Policisë së Qarkut Fier, për “Shërbim transporti, parkim dhe ruajtje të mjeteve të bllokuara”, me fond limit 4 000 000 (katër milionë) lekë”.

Përfundimisht, lejohen të gjitha objektet e prokuruar me financim të huaj të vijojnë normalisht procedurat e prokurimit.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

ANEKSI NR.1

Nr.	Emërtimi
	Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve
1	Furnizim e vendosje me guardrail në Aksin Kalimash – Morinë DR Kukës
2	Mbrojtja e Urës së Drinit Fierzë DR Durrës
3	Shërbim roje civile
4	Kontrata me performancë rruga Fushë-Krujë-Krujë
5	Kontrata me performancë rruga Fushë-Krujë-Ura e Drojës DR Berat
6	Kontrata me performancë rruga Ura e Lirëzës Çorovodë
7	Kontrata me performancë rruga K/Perondi – Uzina e Aviacionit DR Shkodër
8	Rikonstruksion i argjaturës dhe bashkimi me Urën e Spatharit (rruga Shkodër-Mjedë)
9	Rikonstruksion i argjaturës B.Jugë-Ura e Gjolulit
10	Rikonstruksion i Urës së Bunës (seksioni Ura e Bunës, Muriqan
11	Shërbim roje civile
12	Masa inxhinierike Qafë-Mali-Fierzë
13	Kontrata me performancë rruga Qafë Mali-Fierzë
14	Kontrata me performancë rruga K/Hadroj – Qafë Bene
15	Kontrata me performancë rruga Shkodër –Q.Qele
16	Pastrim kanale anësore
17	Riparime dhe zhblokime vepra arti
18	Riparim e mbushje gropa me asfalt
19	Blerje kripe
20	Pastrim bore dhe inerte

	DR Fier
21	Riparim auto
22	Pjesë këmbimi auto
23	Shërbim roje objekti
	DR Dibër
24	Kontrata me performancë rruga Ura Skuraj-Baz
25	Kontrata me performancë rruga Ura -Ulëz-Ulëz
26	Kontrata me performancë rruga Q.Bualli-Krastë
27	Kontrata me performancë rruga Peshkopi-Muhur-Qafë Draje
28	Blerje pjesë këmbimi auto
29	Riparim vepra arti Ura e Cerencit -Steblevë
30	Blerje asfalto-betoni
31	Shërbim roje civile
32	Mirëmbajtje shtresa çakulli rruga Ura e Cerencit-Steblevë
33	Blerje e transport kripe
34	Mirëmbajtje dimërore, pastrim bore dhe shembje
	DR Gjirokastër
35	Kontrata me performancë rruga Jorgucat-Q.Muzinë
36	Kontrata me performancë rruga Dhuvjan-Libohovë
37	Kontrata me performancë rruga Ura e Leklit-Këlcyrë
38	Kontrata me performancë rruga Përmet-Këlcyrë
39	Kontrata me performancë rruga Përmet-Çarshovë-Kufi Leskovik
40	Kontrata me performancë rruga Çarshovë -Tre urat
	DR Vlorë
41	Blerje çakulli
42	Blerje asfalto-betoni
43	Kontrata me performancë rruga Vlorë - Oriku (loti 1)
44	Kontrata me performancë rruga Oriku -Palasë (loti 2)
45	Kontrata me performancë rruga Sarandë -Qafë Muzinë
46	Kontrata me performancë rruga Vlorë-Selenicë
47	Kontrata me performancë rruga Vlorë-Mifol
	DRMF
48	Blerje bojë vijëzimi dhe fosfor
49	Shërbim roje civile të godinës së DRMF
	DR Lezhë
50	Shërbim roje civile, sektori Mirditë
51	Mirëmbajtje dimërore
52	Riparim rruga Prosek-Kurbnesh

VENDIM
Nr.894, datë 10.11.2010

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS LENIE, TË QARKUT TË ELBASANIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Lenie, të qarkut të Elbasanit, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të komunës Lenie, të qarkut të Elbasanit, miratuar me vendimin nr.358, datë 27.3.2008, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Lenie, të qarkut të Elbasanit”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Lenie për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-87	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
88-122	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
123	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shërbimit social	Në pronësi
124-127	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
128	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën administrative	Në pronësi
129-132	Prona që përdoren për realizimin e programeve kulturore	Në pronësi
133-165	Varrezat publike	Në pronësi
467,469-471	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
468	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka jo produktive dhe kanale të treta)	Në përdorim
472-607	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi

VENDIM
Nr.895, datë 10.11.2010

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS BËRDICË, TË QARKUT TË SHKODRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Bërdicë, të qarkut të Shkodrës, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të komunës Bërdicë, të qarkut të Shkodrës, miratuar me vendimin nr.1112, datë 30.7.2008, të Këshillit të

Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Bërdicë, të qarkut të Shkodrës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Komuna Bërdicë, për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën administrative	Në pronësi
2-7,134	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
8-10	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
11-24	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
25,62,67,68,72,73,84,93,95,99,64,89	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproduktive)	Në pronësi
26-57	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë (ish-objekte bujqësore)	Në pronësi
101,102	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
103-116,117,118-133	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
135	Prona që përdoren për realizimin e programeve kulturore, historike e sportive	Në pronësi
136-143	Prona që përdoren në fushën e strehimit dhe të mbrojtjes civile	Në pronësi

VENDIM
Nr.914, datë 17.11.2010

PËR PAGESËN E KONTRIBUTEVE TË NATO-S PËR VITIN 2010

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr.10 100, datë 26.3.2009 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në traktatin e Atlantikut të Veriut”, të pikës 11 të nenit 14 të ligjit nr.8671, datë 26.10.2000 “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit dhe të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministria e Punëve të Jashtme të kryejë pagesën e kontributeve financiare të fondeve të përbashkëta të NATO-s, respektivisht në shumat, si më poshtë vijon:

8438

a) Për buxhetin civil (pjesa e dytë e vitit 2010), në vlerën 8 320 705 (tetë milionë e treqind e njëzet mijë e shtatëqind e pesë) lekë, pagesa të kryhet në llogarinë:

NATO INTERNATIONAL STAF
IBAN BET 73 3100 6652 0060
BIC BBRUBEBB
ING BANK, NATO BRANCH
B-1110 BRUSSELS

b) Për fondin e përbashkët (pjesa civile, viti 2010), të ndërtesës së re të selisë së NATO-s, në vlerën 17 879 208 (shtatëmbëdhjetë milionë e tetëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e tetë) lekë, pagesa të kryhet në llogarinë:

ACCOUNT NAME ALBANIA NEW SITE DELEGATION
IBAN BE 063 10192053622
BIC: BRUBEBB
BANK ING, NATO BRUSSELS-BELGIUM

c) Për fondin kombëtar, në vlerën 19 167 819 (nëntëmbëdhjetë milionë e njëqind e gjashtëdhjetë e shtatëmbëdhjetë e tetëqind e nëntëmbëdhjetë) lekë, pagesa të kryhet në llogarinë:

ACCOUNT NAME NATO
IBAN 310192053622
BIC BBRUBEBB
BANK ING BANK, NATO BRANCH
B-1110 BRUSSELS

ç) Për qiranë e mjediseve ekzistuese të përfaqësisë së përhershme të Republikës së Shqipërisë, në vlerën 43 685 400 (dyzet e tre milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e katërqind) lekë, pagesa të kryhet në llogarinë:

BENEFICIARY NATO INTERNATIONAL STAFF
BANK ING, BANK BRUSSELS-BELGIUM
ACCOUNT 310-0665200-60
IBAN BE73310066520060
BIC BBRUBEBB

d) Për instalimin e mjeteve të komunikimit pranë mjediseve të përfaqësisë në vlerën 13 779 434 (trembëdhjetë milionë e shtatëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e tridhjetë e katër) lekë, pagesa të kryhet në llogarinë:

Beneficiary NATO INTERNATIONAL STAFF
BANK ING, BANK BRUSSELS-BELGIUM
ACCOUNT 310-0665200-60
IBAN BE73310066520060
BIC BBRUBEBB

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.963, datë 24.11.2010

PËR SHTYRJEN E AFATIT TË BOTIMIT TË NJOFTIMIT TË FITUESIT DHE TË NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË LIDHUR PËR PËRFUNDIMIN E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT, ME OBJEKT “SHTYPJEN E “FLETORES ZYRTARE” PËR VITIN 2010”, TË KRYERA NGA QENDRA E PUBLIKIMEVE ZYRTARE, SI AUTORITET KONTRAKTOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe të paragrafit të tretë të pikës 3/ç të kreut I të vendimit nr.1, datë 10.1.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shtyrjen e afatit të botimit të njoftimit të fituesit dhe të njoftimit të kontratës së lidhur për përfundimin e procedurave të prokurimit, me objekt “Shtypjen e “Fletores Zyrtare” për vitin 2010”, të kryera nga Qendra e Publikimeve Zyrtare, si autoritet kontraktor, deri më 31.12.2010.

2. Ngarkohen Ministria e Financave, Qendra e Publikimeve Zyrtare, Agjencia e Prokurimit Publik (APP) dhe Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.974, datë 3.12.2010

PËR SHPALLJEN E GJENDJES SË EMERGJENCËS CIVILE (FATKEQËSISË NATYRORE), NË ZONAT E PËRMBYTURA, SI PASOJË E RESHJEVE NË QARQET E DURRËSIT E TË LEZHËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, të shkronja “c”, e 6, të ligjit nr.8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen e gjendjes së emergjencës civile (fatkeqësisë natyrore), si pasojë e përkeqësimit të kushteve natyrore të motit e të reshjeve në zonat e përmbytura, në qarqet e Durrësit e të Lezhës.

2. Ngritjen e Komitetit Ndërmintor të Emergjencave Civile, i cili të kryesohet nga Zëvendëskryeministri dhe Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe në përbërje të ketë këta anëtarë:

- Ministrin e Brendshëm;
- Ministrin e Mbrojtjes;
- Ministrin e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit;
- Ministrin e Financave;
- Ministrin e Punëve Publike dhe Transportit;

- Ministrin e Shëndetësisë;
- Ministrin e Arsimit dhe Shkencës;
- Shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura;
- Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit;
- Drejtorin e Përgjithshëm të Emergjencave Civile;
- Drejtorin e Përgjithshëm të KESH-it.

3. Komiteti Ndërmintor i Emergjencave Civile të bashkërendojë punën me ministrinë e linjës, me institucionet e prefektëve të qarqeve Durrës e Lezhë dhe me njësitë e qeverisjes vendore, ku është shpallur gjendja e emergjencës civile, për hartimin dhe zbatimin e planit të evakuimit të banorëve të zonave të prekura, për krijimin e kushteve të këtyre banorëve për jetesë, si dhe për marrjen e masave mbrojtëse e rehabilituese në infrastrukturën dhe mjedisin e prekur nga situata e krijuar.

4. Ngarkohen Zëvendëskryeministri dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Komitetit Ndërmintor i Emergjencave Civile, ministrinë e linjës, prefektët e qarqeve Durrës e Lezhë, si dhe njësitë e qeverisjes vendore përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

URDHËR
Nr.147, datë 20.10.2010

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR SPECIFIKIMET NË PROGRAMET E KONTROLLIT TË CILËSISË SË SIGURISË SË AVIACIONIT CIVIL”

Në zbatim të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, të nenit 106 të ligjit nr.10 040 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, si dhe në përputhje me ligjin nr.9658, datë 18.12.2006 “Për ratifikimin e marrëveshjes shumëpalëshe midis Komunitetit Europian dhe shteteve anëtare, Republikës së Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Republikës së Islandës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Serbisë, Republikës së Malit të Zi, ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Mbretërisë së Norvegjisë, Republikës së Rumanisë dhe Misionit Administrativ të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, mbi krijimin e një zone të përbashkët europiane të aviacionit”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores “Për specifikimet në programet e kontrollit të cilësisë së sigurisë së aviacionit civil”, bashkëlidhur këtij urdhri.
2. Ngarkohet Autoriteti i Aviacionit Civil për zbatimin e këtij urdhri.
Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi

URDHËR
Nr.148, datë 20.10.2010

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE PËR
KRYERJEN E INSPEKTIMEVE NË FUSHËN E SIGURISË SË AVIACIONIT CIVIL”**

Në zbatim të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, të nenit 106 të ligjit nr.10 040 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, si dhe në përputhje me ligjin nr.9658, datë 18.12.2006 “Për ratifikimin e marrëveshjes shumëpalëshe midis Komunitetit Europian dhe shteteve anëtare, Republikës së Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Republikës së Islandës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Serbisë, Republikës së Malit të Zi, ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Mbretërisë së Norvegjisë, Republikës së Rumanisë dhe Misionit Administrativ të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, mbi krijimin e një zone të përbashkët europiane të aviacionit”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores “Për përcaktimin e procedurave për kryerjen e inspektimeve në fushën e sigurisë së aviacionit civil”.
2. Ngarkohet Autoriteti i Aviacionit Civil për zbatimin e këtij urdhri.
Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi

Njoftojmë se kanë filluar abonimet për vitin 2011 për Fletoren Zyrtare.

Afati i abonimit mbaron më 31.1.2011.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 6.12.2010

Doli nga shtypi më 6.12.2010

Tirazhi: 2300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja ADEL PRINT
Tiranë, 2010

Çmimi 40 lekë